PAQJA

REVISTË PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË



Viti V/VI. Nr. 49. 19 dhjetor 2010 - 19 janar 2011. Organ i Shoqatës Kulturore "Zëri Ynë" Çmimi 0.80€



Prof. dr. Milazim KRASNIQI

WIKILEAKS: SI TË DALLOHET VRASJA NË IRAK NGA AKTRIMI NË HOLLIVUD

Intervistë me Imer SELMANIN

'DEMOKRACIA E RE' PËRPIQET TË JETË OPOZITË KONSTRUKTIVE

Agim AVDIU

HERË ZHEG, HERË ACAR

Isa MEHMETI

KORRUPSIONI, MESELE SE JO MAHI



Intervistë me analistin shqiptar, Koço Danaj

SHQIPËRIA NATYRALE ËSHTË NJË OFERTË PËR PAQE DHE STABILITET


MREKULLITË
E
KUR'ANIT
SUKSESI I
GARANTUAR



FILOZOFIA
JONË
Ajni Sinani
Islami
besim, ligj, kulturë dhe qytetërim


JETA
DHE
VDEKJA
E MIRA
DHE
E KEQJA


VIOLETË KOKOLLARI
SHPRESA RILIND


Flamur Maloku
Shtresimet
e
tekstit


Blerim HALILI
Çasti
bën
Çudira
Zëri Ynë
Prishtinë, 2008


SYHEJL HAVOLLI
LITAR LOTËSH



Sadbere Hashani
Fitorja është imja



MILAZIM KRASNIQI
VEPRA
Drama


Milazim KRASNIQI
NË ÇFARË KOSOVE DO TË JETOJMË
SPROVA E NJË GAZETARIE KOMENTUESE


Nexhat Ibrahimi
Aspekte të marrëdhënieve
islamo-kristiane
në Mesjetë


Milazim KRASNIQI
E vërteta e Islamit
ndër shqiptarë
Prishtinë, 2006


TË TJERËT
për
ISLAMIN
Ajni Sinani


Grup autorësh
HUTBE
Ramazani


ISLAMI I KEQKUPTUAR
DHE
FATKEQËSIA BOTËRORE
Dr. Milazim Krasniqi


Kronologji
e Historisë
Islame


Zëri Ynë
SHOQATA KULTURORE

përmbajtja











Portreti i muajit: 'Fituesi i kontestuar'.................2

Milazim Krasniqi: Wikileaks: Si të dallohet vrasja në Irak nga aktrimi në hollivud..........................3-4

Intervistë me Koço Danaj 5-7

Gëzim Qerimi: E para PDK-ja, pastaj të tjerat ..8-9

Flamur Hyseni: Për qeverisje më të mirë, opozitë më e fuqishme..10-11

Fatos Rushiti: Korrupsioni, mesele se jo mahi12-13

Lulzim Ahmeti: Remitencat e konsumit 13-14

Astrit Veliqi: Femrat 'pak' të privilegjuara në trashëgimi..15-16

Intervistë me Imer Selmanin........................16-19

Kalendari..20-21

Isa Mehmeti: Nis rifunksionalizimi i Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe 22-23

Muhamed J. Kajolli: Identiteti njerëzor........24-25

John L. Esposito & Sheila B. Lalwani: Koha për të vazhduar tutje...26-27

Mario Vargas Llosa: Kultura e lirisë 28-20

Bilall Maliqi: Poezi që pasqyrojnë realitetin kohor ..31-32

Rrustem R. Berisha: Libri dhe kultura shqiptare 32

Agim Avdiu: Herë zheg, herë acar 33-34

Fatos Shala: Shtohen rastet e infektimit me HIV35

Artan N. Bejta: AIDS-i – lufta e pashpresë mes jetës dhe vdekjes...36-38

Alban Bilalli: Viti 2011 – fundi i izolimit............39

Alban Bilalli: E tërë Evropa pas Xherdan Shaqirit . 40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË

Viti V-VI / Nr. 49

19 dhjetor 2010 - 19 janar 2011

Botues

Zëri Ynë

O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor

Muhamed Jusufi - KAJOLLI

kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës

Avni AVDIU

avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës

Flamur MALOKU

flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika

Osman D. GASHI

osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore

Mimoza SINANI

e-mail:

revistapaqja@gmail.com

revistapaqja@hotmail.com

http://www.zeri-yne.org

Adresa:

Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14, përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

'FITUESI I KONTESTUAR'



Në këto zgjedhje, ndaj kryeministrit në largim Hashim Thaçit, nga të gjitha partitë e tjera u përdor një gjuhë e tejskajshme denigruese, pezhorative dhe jokorrekte. Shkuan aq larg sa e krahasuan me Milloshevicin. Madje njëri nga oponentët në RTK u shpreh se 'po t'i qëllonte Thaçi fqinj, do ta shiste shtëpinë për t'u larguar prej tij'. Me një fjalë, Hashim Thaçi ishte tabelë qitjeje për të gjitha partitë e tjera. Ato duke mos pasur çka t'i ofronin elektoratit, filozofinë politike të suksesit e pandehnin në atë se sa më shumë ta sulmonin atë, aq më shumë do të fitonin. Mirëpo kjo 'logjikë' doli e dështuar dhe pati efekt të kundërt. Populli ishte lodhur nga akuzat, kritikat e sharjet. Ai dëshironte të dëgjonte plane konkrete për zgjidhjen e problemeve. Pas shpalljes preliminare të rezultateve nga KQZ-ja, tek partitë e tjera politike po vërehet tendenca e formulës 'Rama', për kontestimin e zgjedhjeve. Të pakënaqura nga rezultatet dhe në pamundësi të gjejnë arsyetime para elektoratit të tyre, ato i dramatizojnë dy-tri raste të izoluara për parregullsi (Skenderaj, Drenas, Malishevë), raste këto që nuk ndikojnë aspak në rezultatin e përgjithshëm (sepse edhe ashtu po të përsëriteshin zgjedhjet në këto pika, rezultati do të ishte përafërsisht i njëjtë).



Hashim Thaçi lindi në Burojë të Skenderajt, më 24 Prill 1968. I biri i Haxhiut dhe Hyres u rrit në një familje bujare në mesin e 5 vëllezërve dhe motrave. Filloren e kreu në "Liria" të Turiqevcit, ndërsa të mesmen në Qendrën e Arsimit të Mesëm "Ramiz Sadiku" në Skenderaj. Pas diplomimit në Fakultetin Filozofik të UP-së, menjëherë filloi veprimtarinë e tij ilegale për zgjidhjen e çështjes kombëtare. Në Zvicër, Hashim Thaçi u angazhua në Lëvizjen Popullore të Kosovës, organizatë politike e cila themeloi UÇK-në. Mirëpo krahas kësaj, Thaçi vijonte edhe studimet posdiplomike në Universitetin e Cyrihut (Zürich). Bashkëpunoi me shumë shokë (si Adem e Hamzë Jasharin) në aksione të armatosura kundër forcave policore serbe (më 1997 mori pjesë në sulmin ndaj stacionit policor në Drenas). Policia serbe dështoi në përpjekjet për ta burgosur më 1993, kurse Gjykata e Qarkut në Prishtinë e dënoi në mungesë me 10 vjet burg. Në të njëjtin proces u dënua edhe shoku i tij i luftës, komandanti legjendar Adem Jashari me 20 vjet burg. Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së e emëroi drejtues politik të luftës, post të cilin e mbajti gjer më 19 shtator, kur UÇK u transformua në TMK. Ishte kryesues në Konferencën e Rambujesë, në shkurt-mars të 1999. Në mars të po atij viti, u zgjodh kryeministër i Qeverisë së Përkohshme. Në tetor të vitit 1999, së bashku më shokët e tij të LPK-së, themeloi Partinë e Progresit Demokratik të Kosovës (PPDK), ndërsa në Kuvendin e Parë Zgjedhor (2000), u zgjodh kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, (PDK). Në po të njëjtin post u rizgjodh në Kuvendin e Dytë (2002) dhe të Tretë Zgjedhor (2005). Gjatë procesit negociator (2005 – 2007), të udhëhequr nga i dërguari i posaçëm i OKB-së, Presidenti Martti Ahtisaari, ishte anëtar i Ekipit të Unitetit. Pas fitores së Partisë Demokratike të Kosovës në zgjedhjet parlamentare të 17 nëntorit 2007, më 9 janar 2008 u zgjodh Kryeministër i Qeverisë së Kosovës. Më 17 shkurt 2008, Kryeministri Hashim Thaçi në Kuvendin e Kosovës shpalli Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik. Një vit më pas fitoi bindshëm zgjedhjet lokale të 15 nëntorit 2009. Pas tërheqjes së befasishme të partnerit të koalicionit LDK-së nga qeveria, shpalli zgjedhje të jashtëzakonshme, të cilat gjithashtu i fitoi bindshëm. Në zgjedhjet parlamentare të 12 dhjetorit 2010 **P**opulli **D**eshi **K**ështu: PDK = 33.5%; LDK = 23.6%; VV = 12.2%; AAK = 10.8%; AKR =7.1 %; LDD = 3.3%; FER = 2.2 %.

Wikileaks: Si të dallohet vrasja në Irak nga aktrimi në hollivud

Publikimet e Vikiliksit, të cilat e denoncojnë shtetin, cilindo shtet që shpërdoron fuqinë e vet, mund të kontribuojnë për zgjimin e ndërgjegjes së njeriut të sotëm - individit, i cili i bombarduar nga kinematografia, nga televizioni e interneti, i ngulfatur nga oraret e tejzgjatura të punës dhe nga vetmia që prodhon një prirje autiste, nuk arrin të shquajë qartë dallimin ndërmjet pamjeve që tregojnë vrasjen e njerëzve realë në Irak dhe pamjeve kinematografike të Hollivudit

Milazim KRASNIQI



Publikimi i dokumenteve sekrete të administratës amerikane, nga ana e Vikiliksit dhe nga mediet që bashkëpunojnë me të, e ka nxitur fantazinë e të gjithëve që të gjenden definime të reja për natyrën dhe fuqinë e gazetarisë dhe medieve në botën e sotme dhe raportet e saj me pushtetet e tjera. Në këtë rast rezulton se gazetaria nuk është pushteti i katërt, po është pushteti i dytë, duke e këmbyer pozitën me pushtetin ekzekutiv, i cili rezulton të jetë i pambrojtur dhe i pafuqishëm ndaj agresionit të medies. Deklaratat nervoze të sekretares amerikane të shtetit, Hilari Klinton, as nuk e kanë frikësuar e as nuk e kanë zmbrapsur Vikiliksin dhe as partnerët e saj në këtë mesele, *The New York Times*-in, *The Guardian*-in, *Der Spiegel*-in, *El Pais* -in dhe *Le Monde*-in, që të publikojnë materiale të ndjeshme, që e dëmtojnë punën dhe imazhin e qeverisë amerikane. Administrata duhet të japë shpjegime, të shfajësohet, të relativizojë dëmin që i shkaktohet, por ajo nuk ka fuqi që të ndalë publikimin e materialeve të saj, të nxjerra madje ilegalisht. Censura shtetërore nuk ekziston si institucion as në Shtetet e Bashkuara e as në shtetet e tjera demokratike, prandaj nuk ka një instrument që të ndalojë publikimin e paautorizuar të dokumenteve sekrete.

Në historinë e gazetarisë mbahet mend censura parandaluese e filluar që nga Augusti, por e instaluar si institucion nga papa Pavli III, i cili në vitin e largët 1543, futi censurën parandaluese Imprimatur, për të dhënë lejen paraprake për botimin e teksteve. Pasardhësi i tij, papa Pavli IV, mbahet mend që publikoi indeksin e librave të ndaluara, gjë që po ashtu pati ndikime të mëdha në pengimin e lirisë së shprehjes. Sundimtarë të ardhur në pushtet në shekujt XVI e XVII, si Elizabeta në Angli dhe Luigji XIII në Francë, krijuan institucionet e censurës, "Dhoma e Ylltë" dhe "Chambre de Syndicate", për të kontrolluar madje gjithë produktin tipografik. Si për t'i vënë kapakun kësaj tradite të censurës e terrorit mbi fjalën e lirë dhe medien, në periudhën e Revolucionit Borgjez Francez, filloi edhe ndëshkimi i gazetarëve si Kamij Demyleni, të cilit iu pre koka në gijotinë.

Por, si edhe shumë inovacione që kanë ardhur nga përtej Atlantikut, edhe në gazetarinë europiane e botërore, kanë ardhur praktika të reja të lirisë bash nga gazetaria amerikane. Praktikisht, Uilliam Hersti, i cili filloi publikimin e dokumenteve të fshehta të ambasadës spanjolle dhe e nxiti luftën amerikane-spanjolle për Kubën në vitin 1898, është pararendësi i Xhulian Asanzhit. Gazetaria që nuk ka për qëllim raportimin korrekt për ngjarjen, por që e instrumentalizon ngjarjen për qëllimet e veta, që përdor burime të fshehta dhe prodhon sensacionalizëm, që prej asaj kohe është në garë me gazetarinë e përgjegjshme dhe jo rrallë është edhe fituese e betejave ndaj saj. Praktikisht, kur kjo lloj gazetarie sensacionaliste i fiton betejat, atëherë ajo bëhet jo vetëm manipuluese e publikut, por edhe sfiduese e pushteteve të tjera, në rend të parë e pushtetit ekzekutiv. Fatkeqësisht, gazetaria e tillë nuk është informuese, por më shumë prodhuese e hamendjeve përmes mesazheve dhe imazheve të turbullta e turbulluese për mendjet e publikut. Përderisa për filmat që transmetohen në televizion ka një rregull se për cilat mosha është i lejueshëm, për produktet mediatike që turbullojnë emocionet e mendjen e njerëzve nuk ka asnjë rregull. Lajmet televizive me pamje të dhunës reale transmetohen në terminet më të shi-



kuara, pa asnjë lloj ndalese për askënd, edhe pse ato janë skena të dhunës reale (ndërsa dhuna fiktive e kinematografisë është e ndaluar për disa grupmosha). Nëse publiku nuk ka të drejtë të shikojë një film artistik, si paska të drejtë të shikojë vrasjet e njerëzve realë? Më saktë: ku është kufiri se çfarë duhet të dijë publiku e çfarë nuk duhet të dijë, është një pyetje që kurrë nuk ka marrë përgjigje të saktë. A bëhet më i përgjegjshëm njeriu "duke ditur gjithçka", apo duke ditur vetëm ato të vërteta që i ndihmojnë të krijojë opinionin dhe bindjen e duhur, pa qenë i shokuar dhe i paralizuar nga efektet e asaj që i ofrohet si informatë përmes medies? Vikiliks në gjithë këtë tregim vjen si kurorëzim i kësaj gazetarie manipuluese e shokuese.

Apo, mos kjo lloj spiungazetarie e ka goditur shenjën kur i servon pamje/informata që e kënaqin voajerizmin e njeriut të tromaksur? Kureshtja e pafre për të ditur se çfarë bëjnë të tjerët, nga mënyra se si bëjnë seks deri te skenat kur civilët vriten nga ushtarët, është e njeriut të dalë nga orbita e besimit dhe e moralit. Ky njeri dëshiron t'i shohë të gjithë të tjerët, por në dëm të qetësisë e paqes së vet. Me këtë njeri media sensacionaliste luan me të si macja me miun. Por, media që prodhon sensacionalizëm, sfidon edhe qeverinë më të fuqishme të botës, sepse nuk ka mekanizma që e rregullojnë as raportin e individit me medien dhe as të shtetit me medien. Rrjedhimisht, media është mbi të dyja këto instanca, pra mbi individin voajerist dhe mbi shtetin liberal.

Nga ana tjetër, nëse gjykatat në Angli e në Suedi, e humbin kredibilitetin në raport me Xhulian Asanzhin, shefin e Vikiliksit, atëherë edhe pushteti gjyqësor do të jetë i sfiduar nga një pronar mediumi përkatësisht një gazetar investigativ. Dhe mundësia që ta humbin është reale, nëse duan ta ndëshkojnë për një gjë bizare, si puna e fajit për mospërdorimin e kondomit me femrën, e cila ka fjetur me dëshirën e saj me të në shtrat. Drejtësia suedeze do të duhej të ishte më e lumtur nëse nuk e mbërrin dora e saj fare Xhulian Asanzhin. Ndërsa, drejtësia amerikane ka arsye ta kërkojë që ta vërë drejtësinë në vend, por paraprakisht ajo duhet të zgjidhë disa probleme fundamentale të vetat e të shoqërisë amerikane, e që janë të lidhura me amendamentin e parë. Ashtu si janë gjërat sot, drejtësia përkatësisht pushteti i tretë, e ka zor të fitojë ndaj Xhulian Asanzhit.

Pse? Është e qartë se mungesa e rregullave elementare për gazetarinë e internetit dhe internetin në përgjithësi, e bën luftën e pushtetit legjislativ të jetë e humbur nga interneti dhe produktet e tij, e gjithsesi edhe nga sensacionalizmi i Vikiliskit. Megjithatë, pushteti legjislativ është i vetmi që e ka shansin që ta kthejë kahun e kësaj lufte në favor të shtetit ligjor, të drejtësisë e të lirisë. Por për ta arritur këtë gjë, duhet të gjenden zgjidhje ligjore të cilat e kufizojnë keqpërdorimin e gazetarisë, pa e kufizuar lirinë e shprehjes dhe lirinë e medies. Pra, duhet të gjenden formulime ligjore, të cilat e mbrojnë edhe shtetin nga gazetaria. Tingëllon shumë arrogante në raport me gazetarinë e vërtetë, por ajo duhet të mbetet jashtë këtij debati. Këtu tema është gazetaria dëmsjellëse. Vërtet, kur shihet tronditja që i ka shkaktuar Vikiliksi një shteti si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, atëherë vetëm mund ta marrim me mend se si mund të dërrmohen shtetet e brishta nga kjo lloj gazetarie agresive dhe turbulluese.

Por, kjo është vetëm njëra anë e medaljes. Ana tjetër ka të bëjë me faktet e fshehura, për të cilat ekziston interesi që të bëhen publike, qoftë dhe nga gazetaria sensacionaliste, për t'u parandaluar e keqja e radhës. Fjala vjen, vrasjet e civilëve. Transmetimi i CD ku shihet vrasja e civilëve irakianë nga një helikopter amerikan, është në shërbim të denoncimit të së keqes, të krimit. Edhe pse transmetimi i pamjeve të këtilla ende nuk e ka arritur efektin e vet, sepse fantazia e shumë njerëzve ende nuk i ka ndarë plotësisht nga imazhet e injektuara në mendjet e tyre nga kinematografia e Hollivudit, transmetimi i saj është legjitim. Nga ky aspekt, publikimet e Vikiliksit, të cilat e denoncojnë shtetin, cilindo shtet që shpërdoron fuqinë e vet, mund të kontribuojnë për zgjimin e ndërgjegjes së njeriut të sotëm, individit, i cili i bombarduar nga kinematografia, nga televizioni e interneti, i ngulfatur nga oraret e tejzgjatura të punës dhe nga vetmia që prodhon një prirje autiste, nuk arrin të shquajë qartë dallimin ndërmjet pamjeve që tregojnë vrasjen e njerëzve realë në Irak dhe pamjeve kinematografike të Hollivudit. Fatkeqësisht, shteti me fuqinë e vet kolosale, ia ka shpërlarë trurin individit. Ia ka krijuar edhe skemën se si duhet të mendojë, përkatësisht se si të paaftësohet që ta dallojë pamjen reale nga pamje fiksionale, që ta dallojë tragjedinë reale nga figura artistike. A është në këtë rast Vikiliksi alter egoja e këtij individi të tjetërsuar? Këtë askush nuk e di tamam, sepse askush nuk e di qëllimin e Xhulian Asanzhit dhe të kompanionëve të tij, të njohur e të fshehtë. ■

Shqipëria natyrale është një ofertë për paqe dhe stabilitet

"Platforma e Shqipërisë natyrale është një ofertë për paqe dhe stabilitet që i ofrohet të gjithëve. Kush nuk e pranon atë, nuk dëshiron paqen, por mendon dhunën, trazirat ose rebelimet. Pra, rezultati në çdo lloj varianti do të jetë në favor të shqiptarëve. Atë ditë që materiali do t'i dërgohet GJND, do t'u dërgohet edhe ministrive të jashtme të Britanisë së Madhe, të Francës, Rusisë, Gjermanisë, Austrisë dhe Italisë që ishin pjesëmarrëse të Konferencës së Londrës si dhe SHBA-s që sot janë aleati i vetëm strategjik i shqiptarëve", - është shprehur Koço Danaj, shkrimtar dhe politikolog nga Tirana

Intervistoi: Alban BILALLI

Shkrimtari dhe politikologu nga Tirana, aktualisht drejtor i Qendrës së Prognozave Politike dhe Sociale në Tiranë, Koço Danaj, do të paraqesë një ankesë në GJND kundër Konferencës së Londrës së vitit 1913, në të cilën u vendos ndarja e trojeve shqiptare. Në intervistën dhënë revistës "Paqja" ai flet për idenë e tij për ta dërguar ankesën në GJND. Po ashtu, ai flet edhe për të drejtën e popullit shqiptar për bashkim, si dhe për përfitimet që do t'i kenë shqiptarët nga bashkimi në një shtet të vetëm. Për më shumë flet në një intervistë për revistën "Paqja", Koço Danaj, shkrimtar dhe politikolog nga Tirana.

"PAQJA": ***Z. Danaj, prej nga ju lindi ideja për të paraqitur një ankesë në GJND kundër Konferencës së Londrës të vitit 1913?***

DANAJ: Për të gjithë ata që e kanë lexuar Platformën e Listës së Shqipërisë natyrale, të miratuar më 30 tetor 2010, në Tiranë, në praninë e një mijë shqiptarëve të ardhur nga të gjitha trojet, është e qartë se kjo kërkesë është pjesë e Platformës, por nuk është vetë Platforma. Në Platformën e Shqipërisë natyrale thuhet se qëllimi është bashkimi i trojeve shqiptare në rrugë paqësore. Për këtë çështje do të përdoren të gjitha rrugët demokratike dhe institucionale, që nga sensibilizimi i opinionit, pjesëmarrja në institucione në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup, e deri te çuarja e këtij problemi edhe në institucionet ndërkombëtare. Shumëkush e di se Pavarësia e Shqipërisë natyrale e shpallur në Vlorë në vitin 1912, nuk u njoh nga Konferenca e Londrës, e cila e copëtoi kombin shqiptar në 5 pjesë, për të kënaqur fqinjët e Shqipërisë, duke ju dhuruar atyre troje shqiptare. Këtë copëtim e pranuan vetë autorët e Konferencës së Londrës, duke e konsideruar një padrejtësi. Mjafton të përmend vetëm fjalimin e ish-ministrit të jashtëm britanik, Eduard Grei, i cili në Dhomën e Komunave në Londër, e pranoi padrejtësinë, por e justifikoi atë gjoja në emër të paqes. Më vonë, këtë padrejtësi e kanë pranuar edhe pjesëmarrës të tjerë të Konferencës së Londrës, ashtu siç e kanë pranuar këto 20 vjet edhe politikanë të tjerë të njohur, si i ndjeri Robin Kuk, ish-ministër i jashtëm i Britanisë së Madhe, në prill të vitit 1999.

Kjo është pikënisja e idesë, për të cilën pyesni ju, ndërsa vazhdimi i idesë ka të bëjë me njohjen e gjeopolitikës rajonale. Aktualisht, bashkësia ndërkombëtare duket se i është qasur problem-



atikës së rajonit ballkanas, jo për ta zgjidhur atë pjesërisht, jo për ta arnuar, por për ta riformatuar tërësisht. Dhe në kuadrin e këtij riformatimi, hyn edhe kërkesa jonë për të parë ligjshmërinë e kësaj konference, të cilën vetë autorët e saj e konsiderojnë të padrejtë.

"PAQJA": *Kur mendoni ta paraqitni ankesën?*

DANAJ: Mendojmë ta paraqesim brenda muajit janar 2011. Jemi në fund të fazës për grumbullimin e të gjitha materialeve që do të formulohen në një material të vetëm, që nga dëshmitë e politikanëve që nuk janë më, por deklarimet e tyre ekzistojnë, që nga dëshmitë e politikanëve që janë gjallë, e deri te dokumentacioni i organizmave ndërkombëtare që ka të bëjë me problemet nacionale, por edhe me çështjen shqiptare në veçanti.

"PAQJA": *Si mendoni ju, a do ta pranojë GJND-ja kërkesën tuaj dhe cili do të jetë vendimi i GJND-së?*

DANAJ: Nuk është kjo më e rëndësishmja. Me e rëndësishmja është se politikës ndërkombëtare që ka marrë përsipër rolin e arbitrit të problematikes së rajonit tonë, do t'i jepet në dorë një material mbi 100 faqe, në të cilin me dokumente dhe fakte tregohet se si është copëtuar përgjatë një shekulli një komb nga më të vjetrit në Evropë, në mënyrë koloniale, cinike dhe gjenocidale. Dhe pas kësaj, jam shumë i sigurt se GJND-ja ose bashkësia ndërkombëtare do të merren shumë seriozisht me çështjen shqiptare. Platforma e Shqipërisë natyrale është një ofertë për paqe dhe stabilitet që i ofrohet të gjithëve. Kush nuk e pranon atë, nuk dëshiron paqen, por mendon dhunën, trazirat ose rebelimet. Pra, rezultati në çdo lloj varianti do të jetë në favor të shqiptarëve. Atë ditë që materiali do t'i dërgohet GJND-së, do t'u dërgohet edhe ministrive të jashtme të Britanisë së Madhe, të Francës, Rusisë, Gjermanisë, Austrisë dhe Italisë, që ishin pjesëmarrëse të Konferencës së Londrës, si dhe SHBA-së që sot janë aleati i vetëm strategjik i shqiptarëve.

"PAQJA": *Z. Danaj, a kanë të drejtë shqiptarët që të bashkohen në një shtet të vetëm?*

DANAJ: Si nuk kanë të drejtë? Një komb që nuk ka të drejtë të vetëvendosë për fatin e tij, është komb i burgosur. Rëndësi ka që në mjedisin që jetojmë sot, i cili është mjedis demokratik, ky problem i ka të gjitha shanset të zgjidhet në mënyrë paqësore. Pse e them këtë? Shikoni çfarë absurditeti ekziston sot në gjirin e Evropës demokratike. Unë nisem për në Mal të Zi dhe kur kaloj Hanin e Hotit hyj në territor shqiptar, unë nisem nga Kosova për të shkuar në Maqedoni dhe kur kaloj Hanin e Elezit hyj në territor shqiptar. Unë nisem për në Kosovë dhe kur kaloj Qafën e Morinës hyj në territor shqiptar, nisem nga Shqipëria për në Maqedoni, kaloj Qafen e Thanës dhe hyj në territor shqiptar, nisem nga Konispoli për në Greqi dhe kur kaloj Qafen e Botës hyj në territor shqiptar. A mund të lejohet ky absurd, kjo Salamandër etnike në një Evropë demokratike? Jo.

"PAQJA": *Çfarë mendoni ju, kush ka dëshirë më të madhe për bashkim, shqiptarët në Shqipëri apo ne në Kosovë?*

DANAJ: Pyetje e saktë. Ja përgjigja ime: Është njësoj sikur të pyesësh njerëzit se me cilin sy shikojnë më mirë, me syrin e majtë apo të djathtë. Sondazhi i fundit i Gallupit tregoi se shumica dërrmuese e shqiptarëve kërkon bashkimin. Në Kosovë kjo shifër ishte 81 për qind, në Shqipëri 63 për qind, në Maqedoni 52 për qind. Pra shqiptarët e duan bashkimin. Por ka edhe një element tjetër. Në Evropë zhvillohen lloj-lloj referendumesh, për minaret, për qentë se si duhet të trajtohen, etj. Pse nuk na lejojnë të bëjmë edhe një referendum



për kombet, për njerëzit. Dhe në qoftë se referendumi dështon, mbyllet dosja. Por po të bëhet një referendum, të jeni të sigurt se shqiptarët pro bashkimit do të jenë mbi 87 për qind.

"PAQJA": ***Lideri i lëvizjes "Vetëvendosje" është pro bashkimit të trojeve shqiptare. Cili është komenti juaj për këtë?***

DANAJ: Albin Kurti, Liburn Aliu, Avni Klinaku, etj dhe koalicioni i tyre i 'Vetëvendosjes' janë pararoja e bashkimit real të shqiptarëve. Idetë e 'Vetëvendosjes' janë idetë e së ardhmes së kombit shqiptar. Ndërsa idetë e partive të tjera janë idetë e rregullimit dhe menaxhimit të pushtetit aktual. Prandaj ata do të jenë një nga forcat kryesore politike në Prishtinë. Pas 12 dhjetorit, fillon bashkimi real i Kosovës me Shqipërinë. Albin Kurti e dëgjoi bashkësinë ndërkombëtare për të vepruar brenda institucioneve. Por edhe bashkësia ndërkombëtare do t'i dëgjojë dhe do t'i respektojë tezat dhe idetë e 'Vetëvendosjes'. Pra pas 12 dhjetorit, hapet faqja e fundit dhe më kryesorja e bashkimit të shqiptarëve. Imagjinoni 25 deri në 30 deputetë minimumi që në çdo seancë parlamentare do kërkojnë bashkim me Shqipërinë. Edhe bashkësia ndërkombëtare, në këtë rast, do të nxjerrë nga sirtari Planin B.

"PAQJA": ***A ka në Shqipëri organizata që e përkrahin bashkimin me Kosovën?***

DANAJ: Bashkimin me Kosovën e përkrahim më shumë se gjysma e opinionit publik në Shqipëri. Një detaj: në qoftë se në shkallë vendi kjo përqindje ishte 63 për qind, në kryeqytet, pra në Tiranë ishte afër 70 për qind. Ka edhe mjaft organizata të tjera që në mënyrën e tyre e duan bashkimin. Krijimi i Listës për Shqipëri natyrale më 30 tetor 2010, tregoi se edhe në Shqipëri, përveç shumicës së opinionit publik ka edhe forca politike që aspirojnë bashkim me Kosovën dhe krijimin e Shqipërisë natyrale.

"PAQJA": ***Z. Danaj, a jemi më të fortë me një shtet shqiptar apo me dy shtete shqiptare?***

DANAJ: Si thoni ju, a do të ishin më të fortë dy shtete gjermane në fillim të viteve 90-të, apo një shtet gjerman siç është sot? Natyrisht kur bashkohesh je shumë herë më i fortë, edhe





ekonomikisht, edhe politikisht etj. Një shtet i bashkuar shqiptar nuk do grindet se ku do bëhet, apo a duhet të bëhet hidrocentrali i Zhurit. Një shtet shqiptar nuk ka nevojë t'i japë me koncesion një port si Shëngjini shtetit tjetër shqiptar. E merreni me mend absurdin. Unë si shtet shqiptar i jap me koncesion një shteti tjetër shqiptar një territor shqiptar. Dhe e fundit: Vërtet mendoni se BE do pranojë dy ministra shqiptarë në gjirin e saj, një nga Kosova dhe një nga Shqipëria? Asnjëherë. Prandaj teza mbi dy shtete shqiptare është tezë otomane. Sot kombi shqiptar është i organizuar në tre vilajete otomane dhe në dy kaza, vilajeti i Tiranës, i Prishtinës i Tetovës, kazaja e Ulqinit dhe e Preshevës etj. Dhe e fundit fare: Evropa e Bashkuar është bashkim kombesh, por jo grumbuj vilajetesh. ■





E PARA PDK-JA, PASTAJ TË

Gëzim QERIMI

KQZ-ja publikoi rezultatet preliminare pas plot 25 orësh. Sipas këtij rezultati, partia e parë është renditur PDK-ja, me 33.5%.

KQZ-ja ka dalë me shifrat e para zgjedhore, duke komunikuar për publikun se në zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010 kanë votuar 779. 401 votues, ose në përqindje 47. 80 %. Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka ka bërë me dije se procesi zgjedhor ka kaluar në përgjithësi korrekt dhe pa incidente, përveç pjesës veriore të vendit, ku procesi i votimit është ndërprerë para kohe.


Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka ka thënë se rezultatet e 23 vendvotimeve nuk janë futur në rezultatin preliminar. 10 janë nga Prishtina, ndërsa 13 nëpër komunat e tjera.



28 mijë vota janë me kusht dhe nuk janë numëruar ende. KQZ-ja ka bërë të ditur se në rezultatin preliminar janë futur edhe ato nga Skenderaj dhe Drenas.

Kjo është renditja e partive të tjera:
PDK 33.5 % ose 238959 vota
LDK 23 % 168120 vota
VETËVENDOSJE 12.2 % 86924 vota
AAK 10.8 % 76859 vota
AKR 7.1 % 50720
LDD 3.3 % 23337 vota
FER 2.2 % 15559 vota

Krahasuar me zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2007, Partia Demokratike e Kosovës ka ngritje prej 42752 vota , por krahasuar me përqindjen e vitit 2007



ËTJERAT

ka rënie prej – 0.8 % . Duke krahasuar këto statistika dhe rrethanat politike munde të themi se PDK-ja është fituesja kryesore e zgjedhjeve nacionale të 12 dhjetorit 2010.

Lidhja Demokratike e Kosovës, krahasuar me zgjedhjet parlamentare të vitit 2007, gjithashtu ka ngritje të konsiderueshëm në vota, ka 38710 vota më shumë, por rritja në përqindje është solide ose 1 % më shumë se sa në vitin 2007. Edhe pse LDK-ja zgjodhi kryetar Isa Mustafën, si duket kjo gjë nuk ka pasur efekt për ta sfiduar PDK-në e Hashim Thaçit.

Lëvizja "Vetëvendosje" zë vendin e opozitës, edhe pse "Vetëvendosja" për herë të parë ka marrë pjesë në zgjedhjet që janë organizuar dhe ka arritur që të dalë si forca kryesore nga të gjitha partitë opozitare, duke lënë mbrapa vetes AAK-në e Ramush Haradinajt, AKR –në e Behgjet Pacollit, si dhe LDD-në e Nexhat Dacit, e cila nuk ka arritur të kalojë pragun zgjedhor, që është 5 % . "Vetëvendosja", pas këtyre rezultateve, është forca e tretë më e madhe në Kosovë dhe ka fituar 86924 vota ose 12.2% .

Aleanca për ardhmërinë e Kosovës krahasuar me rezultatin e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2007 ka rritje solide, por krahasuar me rezultatin e zgjedhjeve lokale të vitit 2009 ka një rënie drastike përkundër përforcimeve dhe aleancave të shumta që ka bërë me forca të ndryshme, duke përfshirë edhe koalicionin parazgjedhor me Listën Ibrahim Rugova. Sfida kryesore e AAK-së, ashtu si në zgjedhjet e vitit 2007 edhe tani, ka qenë mungesa e liderit të saj Ramush Haradinaj, i cili gjendet në Hagë.

AKR –Aleanca Kosova e Re ka rënie drastike krahasuar me zgjedhjet e vitit 2007, por si duket këtë e kanë pasur parasysh pasi edhe në zgjedhjet lokale të vitit 2009 kishin humbje të shumë votave. Mirëpo si duket AKR-ja e ka kuptuar më mirë se sa LDD-ja rrezikun që të mos mundej e vetme të bënte kapërcimin e pragut zgjedhor prej 5 %, andaj bëri disa përforcime me subjekte të ndryshme politike, të cilat sipas të gjitha gjasave rezultuan edhe të jenë shpëtimi i saj, e sidomos mbështetja e Partisë së Drejtësisë e drejtuar nga Ferid Agani.

Prononcimet e partive politike rrethe rezultateve preliminare

Lideri i lëvizjes "Vetëvendosje", Albin Kurti, në një konferencë për medie ka bërë me dije se rezultatet e zgjedhjeve të shpallura nga KQZ-ja janë të papranueshme dhe si të tilla i ka kontestuar jo vetëm në dy qytetet të rajonit të Drenicës, por në tërë Kosovën."Zgjedhjet e mbajtura të dielën nuk ishin aspak demokratike dhe të ndershme dhe si të tilla janë të papranueshme", - ka thënë Kurti, duke shtuar se një rezultat i tillë vjen si pasojë e ndikimit të regjimit. Ai ka shtuar se nga manipulimet që janë bërë në tërë Kosovën, Lëvizja "Vetëvendosje" është dëmtuar dukshëm në përqindje, por megjithatë ka shtuar se "Vetëvendosje" është më e fuqishme se kurrë.

Deklarohet edhe AKR –ja

Ende kur po kontestohet rezultati i zgjedhjeve dhe shumë ndërkombëtarë kanë ngritur shqetësime për vjedhje, koalicioni për Kosovë të Re, ka një shqetësim tjetër. Koalicioni i shumë partive me në krye AKR-në e Behxhet Pacollit,në një komunikatë për media, flet për krijimin e qeverisë së re. Kjo parti thotë se "nuk ka vija të kuqe me asnjë parti për krijimin e koalicionit".

"Sa i përket krijimit të institucioneve, ne konsiderojmë që sa më shpejt duhet të shihet nëse këto zgjedhje do të certifikohen. Pas kësaj, Kuvendi i Kosovës duhet të konstituohet sa më parë. Lidhur me pjesëmarrjen e Koalicionit në Qeveri, ne mbesim në qëndrimet që i kemi prezantuar para elektoratit dhe opinionit : "Koalicioni nuk ka vija të kuqe ndaj subjekteve politike. Pjesëmarrja jonë në çfarëdo koalicioni tash dhe në të ardhmen, kushtëzohet me hapësirën që ofrohet për të realizuar zotimet tona para zgjedhësve", - thuhet në komunikatë. Koalicioni i fton të gjitha subjektet politike dhe shoqërinë civile, që menjëherë të fillojnë aktivitetet për tejkalimin e dobësive në sistemin zgjedhor.

Isa Mustafa është shfaqur i ashpër kur ka deklaruar se "nuk do të lejojë një qeveri që e ka bazën në votat e vjedhura"

Lidhja Demokratike e Kosovës ka folur për zgjedhjet dhe procesin pas saj. Isa Mustafa është shfaqur i ashpër kur ka deklaruar se "nuk do të lejojë një qeveri që e ka bazën në votat e vjedhura". Në një konferencë për media të Mustafës, në selinë e partisë, u dha edhe një mesazh tjetër. Mustafa tha se LDK-ja nuk do t'i pranojë rezultatet nëse në të përfshihen votat e Skenderajt, Drenasit, Malishevës dhe disa komunave të tjera. Mustafa foli edhe për kryetarin e PDK-së, Hashim Thaçi, kur nënvizoi se "ai ka thyer çdo ligj në këtë vend gjatë procesit zgjedhor". Mustafa nuk përjashtoi mundësinë që të formojë koalicionin zgjedhor nëse i siguron votat e mjaftueshme. ■



Për qeverisje më të mirë

Skenës politike të Kosovës po i mungon ekzistimi i një opozite të mirëfilltë konstruktive dhe unike. Këtë po e mundëson përfaqësimi i interesave të qytetarëve në shumë parti parlamentare gjë që po sjell mosunifikimin e opozitës. E tërë kjo po çon pashmangshmërisht në një zhvillim të jetës parlamentare me opozitë të dobët.


Ma. sc. Flamur HYSENI

Siç po shihet edhe njëmbëdhjetë vite pas çlirimit, demokracisë kosovare nuk po i mjafton të krijojë seriozitetin e të bërit politikë burimore, moderne dhe bashkëkohore. Gjer më tani, kjo demokraci ka pasur rastin të ketë tre mandate të legjislaturave, të cilat nuk kanë arritur të sjellin edhe shumë ndryshime të mëdha, me përjashtim të kësaj të fundit, e cila në koordinim me faktorin politik ndërkombëtar arriti ta shpallë pavarësinë e shtetit, legjislaturë e cila, nëse duhet të hyjë në histori, mund të hyjë pikërisht për këtë arsye.

Skena politike kosovare (pozitë – opozitë) ende nuk po dëshmon se mundet t'i japë fuqi funksionimit të demokracisë në Kosovë. Këtë aq më pak po e dëshmon opozita, e cila nuk po mund të konsolidohet dhe të luajë rolin e saj që i takon të luajë në jetën politike parlamentare në një shoqëri, e cila ka pretendime të ketë institucione demokratike dhe funksionale. Roli i opozitës në zhvillimin, funksionimin dhe forcimin e demokracisë është që të korrigjojë gabimet eventuale të qeverisë dhe të ofrojë zgjidhjen alternative për çështje konkrete. Në kushte normale të ekzistimit të një demokracie normale, opozita ka përgjegjësi thuajse të barabarta nëse nuk gjen alternativa bindëse për t'ia tërhequr vëmendjen qeverisë dhe opinionit publik për çështje të caktuara. Në këtë drejtim, në politikën kosovare është keqkuptuar pozicioni dhe roli i të qenit opozitë. Këtu secila parti po tenton të mos jetë opozitë dhe në momentin e përfundimit të zgjedhjeve dhe shpalljes zyrtare të rezultateve, partitë të cilat nuk përfshihen në qeveri, bien në atë gjendje sikur do të ishte më mirë që të mos ekzistonin fare, gjë kjo e cila nuk do t'i kontribuojë aspak zhvillimit dhe forcimit të demokracisë në vend.

Opozita, të cilën gjer më tani jemi mësuar ta shohim në këto tre mandate, ka qenë opozitë e kritikës pa rezultate të prekshme dhe konkrete, opozitë e një retorike boshe dhe jo një retorike bindëse, opozitë e cila nuk ka qenë unike, por e bajraktarizuar, ku partitë të cilat nuk kanë qenë të përfshira në qeveri, janë munduar të bëjnë një garë ndërmjet tyre se cila do të jetë lidere e opozitës, me kushte që në të ardhmen eventualisht të jenë si alternativë e mundshme për të ardhur në pushtet. Të ekzistuarit e një opozite të fuqishme, do të thotë se do të ketë edhe një qeverisje më të mirë, sepse qeverisja e mirë do të jetë në interes të të gjithë qytetarëve, pavarësisht bindjes së tyre politike.

Skenën politike kosovare po e përfshin edhe një fenomen, të cilin nuk e gjen fare në demokracitë e tjera: ai i transferimeve të politikanëve nga një parti në një parti tjetër. Në një formë, do të ishte e pranueshme nëse do të kalonte ndonjë politikan nga një parti opozitare në një parti në pozitë dhe nga partia në pozitë në partitë në opozitë, por është fare e palogjikshme se si ka mundësi të kalojë nga njëra parti opozitare te tjetra parti opozitare. Kjo kategori politikanësh nuk po jep një shembull të mirë të funksionimit të jetës politike parlamentare të vendit, sepse nuk po tregohet seriozitet në veprimtarinë politike. Këtë po e imponojnë në njëfarë mënyre edhe te gjenerata e re e politikanëve. Mbase



ë, opozitë më e fuqishme

brenda njëzet viteve kjo skenë politike do të zëvendësohet më së paku pesëdhjetë për qind me emra të rinj, të cilët do të kenë fare pak mundësi ta mësojnë zejen e të bërit politikë moderne dhe të shkolluar mirë, sepse këta kuadro politikë – profesionalë nuk po ua mundësojnë, sepse ata, pas dhjetë a njëzet viteve të përvojës së tyre në politikë dhe parti, po e shkatërrojnë atë brenda një dite dhe nuk po dëshirojnë të krijojnë një traditë të përgatitjes së gjeneratës së re të të interesuarve për ta mësuar artin e politikës. Këto veprime çojnë në përfundimin logjik se largimi në këtë mënyrë të vrazhdë nga krijimi i traditës për të krijuar një shkollë politike partiake të qëndrueshme tregon se sa të rastësishëm dhe të papërgatitur kanë qenë disa prej këtyre politikanëve.

Në legjislaturën e katërt, Kosovës i



duhet një strukturë e politikanëve në kuvend, të cilët do të demonstrojnë një kulturë politike të nivelit të lartë. Aq më shumë i duhet një opozitë sa më e fuqishme, e konsoliduar dhe konstruktive, e cila do të jetë shumë bashkëpunuese vetëm atëherë kur do të vijnë në shprehje interesat e përgjithshme shtetërore. Në këtë drejtim duhet të mësojë nga gabimet të cilat po i bën në vazhdimësi skena politike e Republikës së Shqipërisë, e cila ka aktualisht në skenë një opozitë totalisht dekonstruktive dhe jo bashkëpunuese, e cila me këtë stil të luajtjes së rolit të opozitës ia humbi shtetit shqiptar rastin që edhe këtë vit të fitojë statusin e vendit anëtar për anëtarësim në BE.

Pozita dhe opozita kosovare në këtë mandat do të kenë sfida ndër më të vështirat për t'i tejkaluar, sepse janë vite shumë vendimtare ku Kosovën e presin shumë punë në shumë sfera, në raport me politikën e jashtme shtetërore, pastaj duke ia shtuar edhe problemet e brendshme shtetërore, siç është çështja e Mitrovicës, mirëqenia sociale, papunësia, sundimi i ligjit, pavarësia e gjyqësorit e shumë e shumë probleme të tjera.

Kjo legjislaturë, e dalë nga këto zgjedhje, do të ballafaqohet edhe me nisjen e shumë proceseve integruese, do fillojë bisedimet me Serbinë, po ashtu me strukturat e larta të Bashkimit Evropian për liberalizim të vizave. Gjithashtu, ajo do të ketë rastin që gjatë këtij mandati të fillojë edhe bisedimet për statusin eventual të kandidatit për anëtarësim në BE, si edhe mundësinë e nisjes së bisedimeve për integrim në NATO. Të gjitha këto angazhime përgjatë këtij mandati nuk do të jenë të lehta të tejkalohen me sukses, sepse kërkohet shumë punë, përkushtim dhe angazhim politik dhe profesional. Sa do t'ia dalë qeveria e ardhshme, e dalë nga kjo legjislaturë, mbetet të shihet. Në këtë drejtim, nëse do të kemi opozitë të fuqishme dhe tipike parlamentare, atëherë do të ketë edhe një qeveri të mirë, e cila do të angazhohet seriozisht t'u bëjë ballë sfidave, të cilat do ta presin në ditët e para të mandatit.

Demokracia kosovare, edhe ashtu e re dhe e papërvojë me shumë probleme të funksionimit të mirëfilltë të saj, ka nevojë për një opozitë e cila do ta sfidojë qeverinë me ide konkrete, duke mos e



lejuar atë të bëjë gabime. Demokracisë kosovare nuk i duhet aspak një opozitë e tipit që, nga java e parë e fillimit të punës së qeverisë, të kërkojë ta rrëzojë qeverinë, sepse kjo nuk do t'i shërbejë aspak funksionimit të demokracisë në këtë vend dhe kurrsesi as zhvillimit ekonomik të Kosovës. Në legjislaturën e re 2010 - 2014, demokracisë kosovare i duhet një opozitë e fuqishme, për të pasur një qeveri të mirë. ■

(Autori është asistent në Katedrën e Shkencave Kushtetuese – Administrative në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës)



KORRUPSIONI, MESELE SE

Fatos RUSHITI

Kohëve të fundit është fjala me përdorim rekord. Pothuajse nuk ka fjalë më të përfolur. Dikur i thoshin mito e ryshfet, kurse me globalizimin e politikës, ky nocion filloi të hyjë në përdorim edhe te ne, duke shënuar kështu epideminë më të përhapur morale që godet të gjitha sferat e jetës: politikën, kulturën, sportin, institucionet fetare etj. etj.

Ballkani është vrima e zezë e Evropës ku ky fenomen gjen mbështetje më të madhe. Barometri global i korrupsionit 2010, studimi më i madh që bën Transparency International për korrupsionin, reflekton opinionin e njerëzve të thjeshtë. 91.000 vetë në gjithë botën, qytetarë të zakonshëm e jo ekspertë, janë pyetur se si e perceptonin korrupsionin, nëse u është dashur të paguajnë për një shërbim të caktuar, apo se cilët i konsiderojnë ata si sektorët më të korruptuar në vendet përkatëse.

Studimi është bërë në Bosnjë-Hercegovinë, Serbi, Kroaci, Maqedoni, Kosovë e Turqi.

Lidhur me rezultatet e barometrit për vitin 2010 për vendet e Evropës Juglindore, drejtori i drejtorisë rajonale për Evropën Lindore dhe Azinë në Transparency International me qendër në Berlin, Miklosh Marschall është shprehur: "Ka lajme të mira dhe të këqija. Më lejoni të filloj me lajmet e këqija. Në perceptimin global më shumë se 60% e të pyeturve thonë se korrupsioni është rritur...

Lajmi i mirë është se njerëzit janë më të gatshëm për t'u ngritur kundër këtij fenomeni". Një nga pyetjet drejtuar qytetarëve në vende të ndryshme të botës lidhur me korrupsionin ishte nëse ata si individë besonin se njerëzit vetë mund të ndryshonin situatën e korrupsionit? "Në këtë pikë, vendet e Ballkanit Perëndimor janë më pak optimiste se mesatarja globale. Interesante është se në Kosovë kjo e dhënë është shumë e lartë. 74% e njerëzve besojnë se ata mund të sjellin ndryshimin në luftimin e korrupsionit. Ndërsa në Serbi përqindja është shumë e ulët. Aty njerëzit janë më pak optimistë, rreth 40% besojnë në të",- u përgjigj Marschall.

Impresionuese. Shumë kosovarë janë në gjendje ta luftojnë korrupsionin, megjithatë korrupsioni po e bën të veten.

Një nga pikat ku barometri i këtij hulumtimi mat korrupsionin global ka qenë edhe perceptimi për sektorët më të korruptuar. Në nivel global njerëzit e kanë vlerësuar si sektorin më të korruptuar atë të partive politike.

E megjithatë nga fushata parazgjedhore doli se partitë politike janë ato që e luftojnë korrupsionin më së shumti.

Por si qëndron çështja me denoncimin e rasteve të korrupsionit? Këtu Kosova ka zënë një vend shpresëdhënës. "Në Kosovë rreth 91% e të pyeturve, që është një shifër shumë e lartë, thanë se ata do ta raportonin një rast incidenti të korrupsionit. Shifra globale është 71%. Pra lajmi i mirë është se rritja e frustrimit kundër korrupsionit shkon paralel me rritjen e vullnetit për ta denoncuar atë",- pohon Marschall.

Megjithëkëtë, janë tejet të pakta rastet e denoncuara.

Sa i përket korrupsionit, një rast eklatant në Ballkan është edhe ish-kryeministri kroat Ivo Sanader.

Ai akuzohet për keqpërdorim të detyrës zyrtare, megjithëse ende nuk di-



het saktësisht se për cilën lëndë. Sipas informacioneve jozyrtare, bëhet fjalë për agjencinë FIMA Media dhe për Elektroekonominë e Kroacisë (HEP). Në kërkesën e Prokurorisë së Kroacisë theksohet se Sanader dyshohet si i përfshirë në ndërmarrjen kriminale, e cila për qëllim kishte kryerjen e veprës penale.

Paraprakisht, web-faqja WikiLeaks publikoi dokumentet në të cilat thuhej se ambasadori amerikan në Kroaci, James Foley, kishte paraparë arrestimin e Sanaderit, por për shkak të aferës me Hypo Bankën, Ivo Sanader është arrestuar dhe ekstraduar. Me të pritet të merret drejtësia.

Rasti i Sanaderit duhet të shërbejë si shembull. Nuk ka imunitet për deputet e ministra hajna. Atyre duhet t'u hiqet imuniteti dhe të përshpejtohen procedurat ligjore për t'u përballur me drejtësinë.

Korrupsioni si dukuri negative duhet të luftohet në të gjitha sferat. Për fat të keq, këtë e thonë të gjithë. Pajtohen të gjithë. E keqja është se gjithçka mbetet deklarative dhe fare nuk punohet në mënyrë konkrete për çrrënjosjen e kësaj dukurie. ■

Brenda një viti Kosova, pranon para në formë të remitencave rreth 500 milionë euro

Remitencat e konsumit

Shuma e përgjithshme e remitencave të pranuara në vitin 2009 ka arritur në 422.7 milionë euro. Nga kjo shumë mbi 45 për qind kanë qenë para të gatshme, ndërsa pjesa tjetër është shpenzuar për konsum, investime në biznes dhe banim. Për shumicën e remitencave që përdoren për konsum, ekspertët e ekonomisë kanë thënë se kjo është si pasojë e mos hapjes së vendeve të reja të punës nga institucionet e Kosovës

Lulzim AHMETI

Republika e Kosovës, për çdo vit, merr rreth 500 milionë euro në formë të remitencave nga qytetarët e saj, të cilët jetojnë në shtetet e perëndimit. Këto para po luajnë një rol dominues për të mbajtur stabilitetin ekonomik e social në vend. Edhe për një kohë të gjatë, remitencat nga diaspora do të kenë një rol të madh në zhvillimin ekonomik. Por shqetësues mbetet fakti se shumica e dërgesave të mërgimtarëve përdoren për konsum të përditshëm e jo për gjenerimin e vendeve të punës. Ekspertë dhe njohës të rrethanave ekonomike kanë thënë se ky fenomen është si pasojë e mos hapjes së vendeve të reja të punës nga Institucionet e Kosovës. Sipas statistikave zyrtare, në Kosovë rreth 20 për qind e familjeve pranojnë remitenca, shifër kjo që është më e lartë në zonat rurale, sesa në zonat urbane.

Ministri në dorëheqje i Ekonomisë dhe Financave (MEF), Ahmet Shala, ka theksuar se dërgesat nga jashtë po e ndihmojnë shtetin e Kosovës në rrugën e pavarësimit të plotë ekonomik dhe në ndërtimin e institucioneve të qëndrueshme."Roli i remitenacve në ekonominë e Kosovës ka qenë esencial gjatë gjithë historisë së saj, por rëndësia e tyre u rrit në veçanti gjatë dekadës së fundit, ku së bashku me ndihmën e pranuar nga donatorët, remitencat ndikuan ndjeshëm në përmirësimin e zhvillimit ekonomik", - theksoi ministri Shala.

Ndryshe, shuma e përgjithshme e remitencave të pranuara në vitin 2009 ka arritur në 422.7 milionë euro. Nga kjo shumë mbi 45 për qind kanë qenë para të gatshme, ndërsa pjesa tjetër është shpenzuar për konsum, investime në biznes dhe banim.

Por, në pjesën e parë të vitit 2010, dërgesat nga jashtë kanë shënuar një ngritje të vogël, ka thënë Gani Gërguri, ushtrues i detyrës së guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës. "Në gjysmë-vjetorin e parë të këtij viti, kemi rreth 1.3 për qind të remitencave; ndërsa rezultatet preliminare flasin për një rënie të vogël të tyre. Deri në fund të vitit ne presim që, pak a shumë, niveli i remitencave në Kosovë të jetë i ngjashëm me vitin paraprak", - ka theksuar Gërguri.

Ndryshe, sipas një raporti të BQK-së, llogaritet se 400 mijë kosovarë jetojnë jashtë vendit. Po ashtu, në raport thuhet se familjet që pranojnë remitenca fitojnë mesatarisht 480 euro në muaj, nga të cilat 194 euro janë nga dërgesat e familjarëve që jetojnë në diasporë. Këto familje, sipas studimit, shpenzojnë 22 për qind më tepër për kujdesin shëndetësor dhe shtatë për qind më shumë për arsimim.

Ekspertët: Institucionet duhet të angazhohen më shumë

Nagip Skenderi, profesor i ekonomisë në UP, ka thënë se institucionet e vendit duhet të angazhohen më shumë për t'i informuar mërgimtarët për mënyrën e investimit të parave. "Destinimi i të hyrave nga remitencat më tepër drejt konsumit se sa investimeve është si pasojë e politikave të pafavorshme stimulative për investime dhe mungesës së orientimit të këtyre njerëzve përmes këshillave, seminareve dhe formave të tjera informuese për diasporën", - ka thënë Skenderi.

Lumir Abdixhiku ka thënë se është shumë me rëndësi që paratë e remitencave të kanalizohen si investime, të cilat më pas do të hapnin vende të reja të punës, do të bënin përmirësimin e kualitetit të produkteve dhe shërbimeve



dhe me këtë, përmirësimin e standardit të jetesës. Dërgesat e bashkatdhetarëve tanë, pra remitencat, përdoren nga përfituesit e tyre kryesisht për konsum. Mos të harrojmë se Kosova ka një bilanc tregtar dominues me import, pra konsumi në Kosove sigurohet nga importi. Duke njohur natyrën e nomenklaturës ekonomike të Kosovës, pra prejardhjen e konsumit të vendit tonë, një gjë e tillë lë të kuptojë se fatkeqësisht paratë e dërguara nga jashtë nxirren prapë jashtë, sa herë që ato shpenzohen për konsum. Kjo është një arsye më tepër që qeveria jonë, nëpërmjet politikave të saj, të stimulojë më tepër investimet që kanë për burim dërgesat nga jashtë. Kurse Rudina Heroi, nga Instituti për Studime të Avancuara (GAP), vlerëson se migrimi i kosovarëve është më i larti ndër shtetet e Evropës. Afro 400 mijë emigrantë jetojnë jashtë vendit. "Remitencat vlerësohen me rreth 13-15 për qind të Bruto Produktit Vendor (BPV). Për vite të tëra, remitencat kanë luajtur rol të rëndësishëm në uljen e deficitit tregtar, në uljen e varfërisë dhe mund të themi se ato vlerëson si të ardhura substanciale për një numër të madh të popullatës së Kosovës. Megjithatë, sipas të dhënave, mbi 33 për qind e këtyre remitencave përdoren për konsum, ndërsa vetëm 11 për qind përdoren si investime në biznese. Dy dallim kaq i madh i shfrytëzimit të remitencave është si rezultat i kushteve të pavolitshme të ambientit biznesor në Kosovë", - ka thënë Heroi. Sipas raportit "Studimi i Remitencave në Kosovë", thuhet se familjet që pranojnë remitenca kanë të ardhura mujore më të larta sesa familjet që nuk pranojnë remitenca, ndaj dhe ato familje që pranojnë remitenca janë më skeptike ndaj punës dhe me të ardhura më të ulëta. Ambienti biznesor në Kosovë, që është burokratik, me procedura të stërzgjatura dhe kosto të lartë, është një ndër indikatorët permanent, i cili ndikon që shfrytëzimi i remitencave të mos ketë përqendrim të lartë në kategorinë e investimeve në biznes.

"Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të ofrojë kushte më të përshtatshme për investime, sidomos për diasporën. Për çfarë mund të bëjë më tepër Qeveria është edhe subvencionimi i përbashkët i kredidhënies për biznese për emigrantët dhe qytetarët e Kosovës, të cilët shihen si potencial për rritjen ekonomike", - ka shpjeguar Rudina Heroi nga GAP-i.

Artan Nimani, profesor në UP ka thënë se të ardhurat nga diaspora kanë ndryshuar destinimin, gjë që edhe është raportuar nga institucionet, por kanë pësuar edhe rënie remitencat në raporte afatgjata. "Mungesa e një politike të mirëfilltë mbi investimet dhe sigurimin e tyre ka bërë që të hyrat nga jashtë të orientohen kryesisht në konsum dhe pa ndonjë bazë investuese. Këto mjete janë individuale dhe ato vijnë në formë të 'kesh'-it dhe kryesisht shpenzohen nga qytetaret tanë në periudha afatshkurtra", - pohon ai. Sipas Nimanit, mungesa e strategjisë investuese, e sigurisë, e transparencës, si dhe e sundimit të ligjit, janë disa nga arsyet pse diaspora jonë nuk investon në masë të madhe në Kosovë. "Qytetarët tanë jashtë kryesisht kanë jetuar në shtëpi me qira, ndërsa shtëpi permanente të tyret i kanë konsideruar ato në Kosovë. Kjo gjendje ka ndërruar kohët e fundit dhe tash janë fokusuar, më së tepërmi, që të kenë jetë të përhershme në vendet ku punojnë dhe jetojnë, dhe kryesisht investimin e kanë orientuar në vendet ku edhe fitojnë pasurinë", - është shprehur eksperti Artan Nimani.

Por më shqetësues është edhe fakti se shumë të rinj do të migronin për një rrogë më të mirë. Hulumtimi për remitencat ka nxjerrë detaje edhe sa i përket migrimit të kosovarëve.

Në hulumtimin mbi remitencat në Kosovë, 30 për qind e të anketuarve, prej 4 mijë familjeve, janë deklaruar se një kosovar do ta lëshonte Kosovën për dy mijë euro pagë jashtë vendit. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë, gjithashtu, se 16.3 për qind e familjeve të anketuara kanë planifikuar që, në një të ardhme të afërt, ta lënë vendin.

"Zgjedhjet më të preferuara për cakun e dëshiruar të vendit të emigrimit janë Gjermania dhe Zvicra", - thuhet në këtë hulumtim. Konstatime interesante janë edhe dallimet mes familjeve që pranojnë para nga jashtë dhe atyre që nuk e kanë askënd në diasporë. Ka dalë që papunësia është më e lartë në mesin e familjeve që pranojnë remitenca, sesa tek ato që nuk pranojnë. "Familjet që nuk pranojnë remitenca kanë tendencë të kenë më pak anëtarë të papunë në familje", - është shpjegimi që jep ky hulumtim.

Zbërthyer në shifra, familjet kosovare që pranojnë remitenca kanë të ardhura mujore prej 442 euro dhe në kushte reale fitojnë më pak. Kështu 67.5 për qind prej këtyre familjeve fitojnë më shumë se 200 euro në muaj, krahasuar me 80.4 për qind të familjeve që nuk pranojnë dërgesa nga jashtë. Ndërkaq, nëse të ardhurat nga remitencat përfshihen si pjesë e të ardhurave mujore të familjeve, studimi konstatoi se familjet që pranojnë para nga jashtë fitojnë, mesatarisht, më shumë se familjet që nuk pranojnë para.

"Në mënyrë të veçantë, familjet që pranojnë remitenca fitojnë, mesatarisht, 480 euro në muaj, nga të cilat 194 euro janë nga remitencat. Familjet që nuk pranojnë remitenca fitojnë, mesatarisht, 434 euro në muaj", - tregon ky studim. Gjithashtu, dallime vërehen edhe te shpenzimet. Marrë në përgjithësi, një familje në Kosovë shpenzon mesatarisht mbi 410 euro në muaj. Edhe këtu ka një ndryshim të rëndësishëm midis nivelit të shpenzimeve të familjeve që pranojnë remitenca dhe familjeve që nuk pranojnë. Të parat ka dalë që shpenzojnë mesatarisht 445 euro në muaj, ndërsa familjet që nuk pranojnë remitenca shpenzojnë 377 euro. Shumica e emigrantëve që dërgojnë para në Kosovë jetojnë në vendet e Evropës Perëndimore, veçanërisht në Gjermani dhe Zvicër. ■

Trashëgimia e femrave mes traditës dhe të ardhmes

FEMRAT ‘PAK’ TË PRIVILEGJUARA NË TRASHËGIMI

Astrit VELIQI

Trashëgimia e prindërve për vajzat është një fenomen që në shoqërinë tonë edhe nuk pi ujë aq shumë, megjithatë në vendet e rajonit kjo gjë është më se normale.

Por edhe pse mendohet kështu, qytetarët kosovarë mendojnë se trashëgimia duhet të ndahet në mënyrë të barabartë.

I riu Bujar Stojkaj mendon se edhe femrat, sikurse meshkujt, duhet ta gëzojnë trashëgiminë e prindërve.

“Trashëgimia duhet të ndahet në mënyrë të njëjtë për të dyja gjinitë, ngase edhe femra është pjesë e familjes dhe mendoj se në bazë ligjore edhe duhet të jetë kështu”, - thotë Bujari.

Por ai e pranon se një fakt i tillë nuk ndodh në Kosovë dhe ky parim, në shumë raste, edhe nuk respektohet te ne.

Megjithatë Bujari e mohon faktin së meshkujt kosovarë nuk dëshirojnë t’u lënë motrave pasuri siç thuhet, pasi sipas tij nuk është në traditën e shqiptarëve që t’i hedhin motrat në rrugë, ose të mos i respektojnë ato.

Pika e moralit – motra

“Ju e dini që pika më e fortë e moralit te ne është motra, por në të kaluarën ka qenë një traditë e keqe që vajzave nuk u kanë lënë pasuri, pasi që është konsideruar se motra e ka të pamurit te vëllai dhe kjo është e rëndësishme”, - shprehet ai.


Bujar Stojkaj

Bujari mendon se në të ardhmen me pavarësinë e femrës në përgjithësi ndarja e pasurisë do të bëhet e njëjtë për të gjithë, pasi që është e rëndësishme që edhe vajzat dhe djemtë të jenë të barabartë në pasurinë e babait.

Ne e dimë që do të kalojë një kohë e gjatë derisa të bëhemi si evropianët, por nuk besoj se mund të jetë e njëjtë, pasi që edhe karakteri i shqiptarëve është i tillë. Motra respektohet, por jo edhe në ndarje të pasurisë.

“Më shumë respektohet në forma të tjera siç janë mikpritja, vizitat që janë të zakonshme e të tjera”, - thotë ai.

Ndërsa në të shumtën e kohës edhe pse vajzat te ne janë pjesë e pasurisë, ato e refuzojnë një gjë të tillë.

Kaltrina Dervishaj nga Prishtina thotë se nuk ka dashur që ta marrë pasurinë e vëllait me gjithë të drejtën për ta marrë atë.

“Tradita është e tillë, prandaj femra kosovare nuk kërkon pasuri të familjes, pasi që është konsideruar se ajo e ka te burri atë”, - shprehet ajo.

Ligji i favorizon të dyja gjinitë

Kurse Shefqet Buqaj, shef i sektorit të gjendjes civile në Kuvendin Komunal të Prishtinës, thotë se ata veprojnë duke u bazuar në ligj dhe se pasuria ndahet e njëjtë për të dyja gjinitë. Megjithatë, në Kosovë ka qenë traditë që meshkujt edhe në këtë sferë të jenë më të privilegjuar.

“Ne respektojmë ligjin ku të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me trashëgiminë e pasurisë duhet t’iu bashkëngjiten edhe certifikata e lindjes së të gjithë fëmijëve, si të meshkujve ashtu dhe të femrave”, - tha ai.

Buqaj ka nënvizuar se ka pasur raste kur pasuria i është ndarë të dyja gjinive,





por në shumicën e rasteve kanë qenë trashëgimtarë meshkujt.

"Palëve ne u kërkojmë të gjitha ato dokumentet që kërkohen sipas ligjit në fuqi në Kosovë dhe kështu bëhen trashëgimtarë të pasurisë", - ka përfunduar ai.

Barazinë e bën civilizimi shoqëror

Ndërsa Ardita Prizreni-Rizvanolli, drejtoreshë ekzekutive në shoqatën e grave "Vizioni i ri", ka thënë se është obligim prindëror që vajzave t'iu ndahet pasuria sikur edhe djemve.

"Ne duhet të jemi një shoqëri e emancipuar dhe të bëjmë përpjekje që të tregohemi të civilizuar dhe t'i zhdukim ato prapambeturi, të cilat janë si pasojë e një tradite që nuk ka qenë shumë e emancipuar", - ka thënë ajo.

Rizvanolli potencon faktin se akoma në vendin tonë nuk u ndahet pasuria vajzave dhe kjo gjë që nuk është e drejtë.

"Ne investojmë tek fëmijët, pa marrë parasysh se është djalë apo vajzë, prandaj edhe pasuria duhet të ndahet e barabartë për të dyja gjinitë dhe kjo do të tregojë se ne po shkojmë drejt civilizimit dhe përparimit", - shprehet ajo.

Sido që të jetë, tradita dhe e kaluara e shqiptarëve në Kosovë e më gjerë ka qenë që vajzës të mos i jepet pasuri, pasi është konsideruar që ajo e ka pasurinë vetëm në formën e vizitës dhe qëndrimit te familja.

Andaj, sipas kodeve e traditës shqiptare, vajza ka të drejtë që shtëpinë e familjes ta konsiderojë si të veten edhe pas martesës. ■


'DEMOKRACIA E RE' PËRP

Intervistoi: Iljasa SALIHU

Flet lideri i partisë 'Demokracia e Re', Imer Selmani. Ai mendon se afera e dosjeve në Maqedoni i dëmton më së shumti shqiptarët, duke e shpërqendruar vëmendjen ndaj problemeve më esenciale me të cilat përballet populli shqiptar. Ai është i mendimit se partia shqiptare, partnere në qeverisje me VMRO-DPMNE, BDI-ja, nuk po punon sa duhet për ta avancuar pozitën e shqiptarëve.

PAQJA: ***Deri sa ishit kryetar i Komunës së Sarajit, pastaj Ministër i Shëndetësisë në Republikën e Maqedonisë, s'kishte njeri që nuk thoshte fjalë miradije për ju, por kur e braktisët PDSH-në, filloi një propagandë e ngjeshur kundër jush. Vallë kjo është filozofia e partive politike shqiptare?***

SELMANI: Është e vërtetë se puna ime si kryetar i komunës së Sarajit dhe pastaj si Ministër i Shëndetësisë u mirëprit nga qytetarët shqiptarë, për vetë faktin se arrita të realizoj projekte të shumta, të cilat ndikuan pozitivisht në jetën e përditshme, fillimisht të banorëve të komunës së Sarajit, pastaj edhe të gjithë qytetarëve të Maqedonisë, si Ministër i Shëndetësisë. Fatkeqësisht, pas largimit tim nga PDSH-ja dhe themelimin e 'Demokracisë së Re', propaganda kundër meje u aktivizua pikërisht nga ai subjekt, i cili rrihte gjoksin se kishte kryetarin më të suksesshëm të një komune, ministrin më të suksesshëm shqiptar në Qeveri e kështu me radhë. Më gëzon fakti se kjo anti-propagandë nuk gjeti sukses te populli, i cili vazhdon të më përkrahë edhe më shumë në angazhimin tim politik, për t'i ofruar shqiptarëve ardhmëri të sigurt dhe perspektivë evropiane.



PAQJA: ***Themelimi i partisë 'Demokracia e Re' ishte planifikim i mëhershëm, apo lindi si rrjedhojë e moszgjidhjeve të shumë problemeve shqiptare në Maqedoni?***

SELMANI: Dalja e 'Demokracisë së Re' në skenën politike shqiptare në Maqedonisë ishte nevojë e patjetërsueshme e kohës, veçanërisht pas zgjedhjeve të fundit parlamentare, të cilat sollën në piedestal armiqësitë dhe urrejtjen ndërshqiptare mes partive politike. Kjo situatë, mua si individ, por edhe shumë



PIQET TË JETË OPOZITË KONSTRUKTIVE



shqiptarëve na detyroi që të ofrojmë një projekt të ri politik, i cili do zbuste klimën politike ndërshqiptare, por edhe do të ofronte zgjidhje për problemet e kamotshme të shqiptarëve në Maqedoni. Qasja jonë konstruktive dhe e ndërgjegjshme ndaj halleve të qytetarëve mori shumë shpejt pëlqimin e popullit shqiptar dhe përkrahja e qytetarëve sa shkon e rritet. Jam i bindur se kjo politikë ndryshe, me përcaktime të qarta programore për marrëdhënie të relaksuara ndëretnike, për zhvillim ekonomik më të shpejtë dhe integrim të plotë të Maqedonisë në NATO dhe BE, do të legjitimohet edhe zyrtarisht në zgjedhjet e ardhshme parlamentare.

PAQJA: ***Sa arritët që populli ta kuptojë thelbin veprues të partisë suaj, si dhe epërsia juaj në garën presidenciale, a ishte njëherësh edhe tregues i saktë për përkrahjen e DR-së?***

SELMANI: Oferta politike e Demokracisë së Re në zgjedhjet lokale të vitit të kaluar dhe e imja si kandidat për president të Maqedonisë ishte e kapshme për qytetarët dhe ofronte zgjidhje të qëndrueshme për çështjet e hapura në vend. Arritëm që vetëm pas 3 muajve funksionim të partisë të garojmë në zgjedhje dhe të arrijmë sukses në zgjedhjet lokale, ndërsa sa i përket zgjedhjeve presidenciale, unë si kandidat shqiptar mora 150.000 vota nga qytetarët e të gjitha bashkësive etnike, duke i thyer kështu barrierat dhe stereotipet etnike në Maqedoni. Kjo përkrahje sigurisht se paraqet tregues relevant për përkrahjen e qytetarëve ndaj politikbërjes së Demokracisë së Re, por njëkohësisht imponon përgjegjësinë edhe më të madhe për të vazhduar në rrugën tonë të drejtë.

PAQJA: ***Frekuentimi i shpeshtë i xhamive nga ana juaj dhe personelit tuaj, nga një pjesë e popullatës kuptohet dhe thuhet se kjo gjë bëhet për poenë politikë. Kësisoj, para se të hynit në politikë, a e kishit në agjendën tuaj ditore dhe javore shkuarjen në xhami?***

SELMANI: Unë rrjedh nga një familje tradicionale e cila e praktikon fenë islame. Gjyshi im ka qenë hoxhë dhe imam në fshatin ku unë jetoj. Shkuarja në xhami për mua, sikur edhe për të gjithë muslimanët, paraqet ritual dhe obligim fetar. Në xhami nuk ka vend për politikë dhe marketing.

PAQJA: ***Mendoni që çdo gjë paqësore, edhe pas konfliktit të vitit 2001 në Maqedoni, ka dështuar?***

SELMANI: Mendoj se një politikë më e mençur pas konfliktit të vitit 2001, e cila do të realizonte në tërësi Marrëveshjen Kornizë të Ohrit dhe do të praktikonte frymën e saj të barazisë, tolerancës dhe bashkëjetesës ndëretnike nuk do të lejonte dështimet me të cilat po ballafaqohemi sot si shqiptarë. Kjo vlen veçanërisht për dyvjeçarin e fundit, në të cilin mbizotërojnë politikat dhe vendimet nacionalromantike, monoetnike dhe monofetare të VMRO-DPMNE-së, ndërsa të njëjtin fatkeqësisht me miratimin e partisë shqiptare në pushtet,BDI-së. Enciklopedia e cila i fyen shqiptarët, vendimi për mësimin e maqedonishtes nga klasa e parë për nxënësit shqiptarë, stimulimi i natalitetit vetëm në zonat e





banuara me maqedonas duke diskriminuar nënat shqiptare, projekti famëkeq "Shkupi 2014" pa asnjë element të historisë dhe kulturës shqiptare dhe së fundmi, ligji për regjistrimin e popullsisë, i cili përjashton nga procesi i regjistrimit mbi 1/3 e shqiptarëve të Maqedonisë, që përkohësisht jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, kanë acaruar tej mase marrëdhëniet ndëretnike dhe shteti po ecën në rrugë të gabuar dhe të rrezikshme.

PAQJA: ***Si e shihni zgjidhjen e çështjes shqiptare në Maqedoni: përmes marrëveshjeve të reja politike, apo përmes marrëveshjes ekzistuese?***

SELMANI: Marrëveshja Kornizë e Ohrit është në parim një marrëveshje e mirë dhe paraqet burim të pashtershëm për zgjidhjen e çështjeve ndëretnike në Maqedoni. Fakti se realizimi i saj po i tejkalon të gjitha afatet te shqiptarët, ndjell një pakënaqësi dhe pesimizëm se e njëjta nuk plotëson kërkesat reale të shqiptarëve për barazi politike, ekonomike dhe sociale në vendin tonë. Unë mendoj se Marrëveshja e Ohrit mund të realizohet. Ajo që mungon për momentin është vullneti politik i qeverisë aktuale VMRO-BDI për ta realizuar skajshmërisht atë. Për këtë çështje, faj të madh ka edhe BDI-ja, e cila u bë pjesë e qeverisë pa koncept dhe strategji për realizimin e MKO-së, andaj sot gjendet në pozicion inferior dhe nënshtrues si partner qeverisës.

PAQJA: ***Cili do të ishte hapi i parë, që ju do ta kishit bërë po të vinit në qeveri?***

SELMANI: DR-ja si përfaqësuese e shqiptarëve në qeverinë e ardhshme do t'i bëjë shqiptarët pjesë institucionale e shtetit, me të drejta dhe përgjegjësi të barabarta, si partner i vërtetë në qeverisje, e jo vetëm dekor sikur ka qenë deri më tani. Hapi i parë dhe më i rëndësishëm që do të ndërmarrim si parti në qeverisjen e ardhshme është marrëveshja me partnerin maqedonas për zgjidhjen e afatizuar të çështjeve të hapura të shqiptarëve në Maqedoni, ku theks të veçantë do të ketë realizimi deri në fund i Marrëveshjes së Ohrit. Njëkohësisht, ndarja e pushtetit qendror do të jetë proporcionale, ndërsa kjo nënkupton edhe një fakt – njëri nga tre funksionet më të larta të shtetit (President, Kryeministër, Kryetar i Parlamentit) do t'i takojë shqiptarëve!

PAQJA: ***Prej publikimit të dosjeve kush fitoi dhe kush humbi. Sa besoni ju dhe partia juaj në vërtetësinë e atyre dosjeve?***

SELMANI: Në tërë këtë lojë të ndotur të dosjeve të liferuar nga qarqe të ndryshme politike, që kanë për qëllim nxirjen e imazhit të popullit shqiptar, jo vetëm në Maqedoni por në përgjithësi, nuk ka fitues, përkundrazi, ka vetëm një humbës dhe ai është populli shqiptar. Se pse ndodh kjo, unë nuk mund ta di me saktësi, por dyshoj se qëllimet janë më shumë politike dhe të interesave personale ose grupore për të ardhur me çdo kusht në pushtet. Unë dhe Demokracia e Re, në parim, i kemi hezituar komentimit të përmbajtjeve të dosjeve dhe këtë parim do të respektojmë deri në fund.

PAQJA: ***Dëgjojmë se partia juaj është më e zëshme rreth çështjes së regjistrimit të përgjithshëm që do të bëhet në prill të vitit 2011. Në cilin domen konkretisht mendoni se shqiptarët do të humbin?***

SELMANI: Ne kemi kundërshtuar ashpër propozim-ligjin për regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, pasi që kemi detektuar defekte të shumta në të, por ajo që na bën jashtëzakonisht të shqetësuar është tendenca e qeverisë aktuale për të na nxjerrë ne shqiptarët më pak se sa jemi realisht si popull në Maqedoni. Fakti se me regjistrim në prill do të anashkalohen nga regjistrimi mbi 250.000 shqiptarë, të cilët punojnë dhe jetojnë përkohësisht jashtë vendit, flet qartë se sa real do të jetë ai regjistrim. Andaj, ne kërkuam që regjistrimi të mbahet në korrik, kur mërgimtarët të kthehen në vendlindje dhe mund të regjistrohet. Ne organizuam edhe protestë, e cila mori përkrahjen e shumë subjekteve politike

opozitare shqiptare, organizatave joqeveritare dhe shoqatave të shumta nga Maqedonia dhe jashtë, si dhe përkrahjen e plotë të diasporës shqiptare, e cila pajtohet me kërkesën tonë për regjistrim në korrik. Ligji u miratua në Parlament, pa asnjë ndryshim rrënjësor. Ne nuk do të ftojmë shqiptarët në bojkot, sepse jemi të vetëdijshëm se bojkoti do të çojë ujë në mullirin e kryeministrit Gruevski dhe Qeverisë aktuale VMRO-BDI dhe do t'i amnistojmë politikat antishqiptare dhe përjashtuese të saj. Andaj, paralelisht me regjistrimin e popullsisë vitin e ardhshëm, ne do të organizojmë regjistrimin e shqiptarëve, nënshtetas të Maqedonisë, në Evropë dhe SHBA. Këtë aktivitet do ta realizojmë në bashkëpunim me shoqatat shqiptare, veprimtarë dhe aktivistë të shumtë të kauzës shqiptare në diasporë. Me këtë, do t'i dëshmojmë pushtetit aktual se jemi shumë më tepër nga ajo që ata tentojnë të na paraqesin.

PAQJA: ***Sa arritën shqiptarët e Maqedonisë që të marrin pjesë në kulaçin e buxhetit, apo u mjaftuan me thërrmijat e atij kulaçi? Mendoni se Komuna e Likovës (sikurse edhe shumë komuna të tjera), anashkalohet thuajse tërësisht prej projekteve që duhet të financohen prej buxhetit të përbashkët shtetëror?***

SELMANI: Është e vërtetë se, në vazhdimësi, po ndodh diskriminimi i shqiptarëve përmes përpilimit dhe ndarjes së buxhetit të shtetit. Ne edhe vitin e kaluar, edhe gjatë rebalancëve të buxhetit shtetëror, tentojmë të bindim qeverinë që të ndajë proporcionalisht mjete edhe për shqiptarët, por fatkeqësisht hasim në vesh të shurdhër. Edhe për buxhetin e vitit të ardhshëm propozuam rreth 400 amendamente, projekte për infrastrukturën në vendbanimet shqiptare, për arsimin shqip, për kulturën shqiptare, por asnjë amendament nuk u pranua nga shumica qeveritare. Është për t'u habitur fakti se këto amendamente refuzohen edhe nga BDI-ja, edhe pse të njëjtat kanë për qëllim korrigjimin e ndarjes së buxhetit dhe përmirësimin e kushteve për jetesë për shqiptarët. Shembull eklatant për diskriminim buxhetor është Likova, por fatin e njëjtë tanimë po e ndajnë të gjitha komunat shqiptare. Nga ana tjetër, qeveria vazhdon të ndajë qindra miliona euro për buste, skulptura, porta triumfale, ndërtesa administrative luksoze, përderisa shqiptarët ballafaqohen me probleme ekzistenciale si mungesë e rrugëve të asfaltuara, shkollave për vijim të arsimit fillor dhe të mesëm, spitaleve në zonat rurale, kanalizimit e ndriçimit të rrugëve.

PAQJA: ***Çfarë raporte keni me partitë e tjera shqiptare, po ashtu edhe me ato maqedonase, kur kihet parasysh fakti se të gjitha kërkesat tuaja hidhen poshtë?***

SELMANI: Ne jemi parti skajshmërisht opozitare dhe kundërshtojmë çdo politikë kundër interesave të shqiptarëve. Ne nuk bëjmë kompromise në dëm të tyre, siç ndodh me partinë shqiptare në pushtet BDI-në, andaj do të vazhdojmë të jemi edhe më të zëshëm në kritikat, por edhe sugjerimet dhe alternativat tona për pushtetin aktual. Në veprimin e deritanishëm si parti politike kemi dëshmuar se çdoherë kur është në pyetje interesi kombëtar dhe mbipartiak, jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me të gjitha partitë politike shqiptare. E tillë ka qenë përkrahja pa kushte në raundin e dytë zgjedhor në Strugë, kur rrezikohej fitorja e kandidatit shqiptar nga një tjetër joshqiptar. Të tilla ishin propozimet për ndryshime kushtetuese me të cilat u pajtua edhe BDI-ja, e të cilat parashihnin instalimin e votimit të dyfishtë (parimin e Badenterit) në sistemin gjyqësor për t'i ikur majorizimit të shqiptarëve, si dhe miratimin e buxhetit në Parlament, po ashtu me parimin e Badenterit, për të pamundësuar diskriminimin buxhetor të shqiptarëve. Këto propozime u hodhën poshtë nga partitë maqedonase, por as ato nuk arritën të kalojnë propozimet e tyre për ndryshime në Kushtetutë pa konsensus me partitë shqiptare. Mbipartiake dhe me interes kombëtar ishte edhe iniciativa ime për arritjen e një konsensusi ndërpartiak të shqiptarëve në Maqedoni për disa çështje më të rëndësishme, por e njëjta nuk u pranua nga dy liderët e tjerë të partive parlamentare shqiptare.



PAQJA: ***Mendoni se shqiptarëve në Maqedoni i nevojiten edhe parti të tjera politike, siç flitet për daljen në skenë të partisë politike të z. Rufi Osmanit?***

SELMANI: Ne respektojmë parimet e demokracisë dhe vlerësojmë se secili ka të drejtë të testojë ofertën politike te populli, i cili në fund vendos nëse do të përkrahë apo jo një parti politike.

PAQJA: ***Si e komentoni zhvillimin e fushatës parazgjedhore në Kosovë?***

SELMANI: E kam përcjellë fushatën aq sa më ka lejuar koha dhe mund të konstatoj se në margjina, ajo ishte e rregullt dhe ligjore. Minus i fushatës ishte kohëzgjatja e shkurtër. Mendoj se populli i Kosovës nuk pati kohën dhe hapësirën e mjaftueshme për të dëgjuar ofertat dhe programet e partive politike, që do të ndihmonte përzgjedhjen e tyre dhe delegimin e sovranit për një opsion, i cili do të qeveriste më së miri Kosovën. Shpresoj se edhe këtë herë Kosova do të dëshmojë kapacitetin e saj si shtet i pavarur dhe se edhe këto zgjedhje do të jenë të lira dhe demokratike.

PAQJA: ***Për në fund nëse keni të shtoni diçka?***

SELMANI: Shpresoj se shumë shpejt konstelacionet e reja qeverisëse politike në Maqedoni dhe Kosovë do të mund t'iu përgjigjen nevojave të qytetarëve tanë për një jetë më të mirë dhe më dinjitoze për ta. Ajo që e ndajmë si shqiptarë dhe si qytetarë të dy vendeve është nevoja imanente për zhvillimin e kapaciteteve demokratike në vendet tona, progres ekonomik dhe hapje të vendeve të reja të punës, si dhe integrimi i plotë i vendeve tona në strukturat euro-atlantike, si alternativë e vetme për ardhmërinë tonë si vende të rajonit, veçanërisht për gjeneratat e reja. ■

2011

JANAR

D	H	M	M	E	P	Sh
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

SHKURT

D	H	M	M	E	P	Sh
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28					

MARS

D	H	M	M	E	P	Sh
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		

PRILL

D	H	M	M	E	P	Sh
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30

MAJ

D	H	M	M	E	P	Sh
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

QERSHOR

D	H	M	M	E	P	Sh
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30		

KORRIK

D	H	M	M	E	P	Sh
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
31						

GUSHT

D	H	M	M	E	P	Sh
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

SHTATOR

D	H	M	M	E	P	Sh
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	

TETOR

D	H	M	M	E	P	Sh
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

NËNTOR

D	H	M	M	E	P	Sh
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30			

DHJETOR

D	H	M	M	E	P	Sh
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

REVISTË PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË
PAQJA

Edhe një vit me ju, në rrugëtimin tuaj!

Nis rifunksionalizimi i Këshillit N


Isa MEHMETI

Problematika e ngritur për gjuhën standarde shqipe, si duket do të ketë rastin për herë të parë të diskutohet në një nivel më institucional gjatë këtij muaji, ngase të gjitha debate dhe propozimet, gjer më tani më së shumti janë shtruar në rrugë mediatike. Nga mesi i këtij muaji, Qendra e Studimeve Albanologjike mban në Durrës konferencën treditore shkencore: “Shqipja në etapën e sotme, politikat e pasurimit dhe të përmirësimit të standardit”. Përkundër faktit që thuhet se në miratimin e gjuhës së sotme standarde ka pasur gisht politika e dikurshme, ekziston droja se sërish mund të jetë pikërisht politika ajo që kërkon rishqyrtimin e kësaj çështjeje.

Sipas studiuesit Arshi Pipa, gjuha e Fishtës, e Mjedës, e Koliqit, e Migjenit, gjegjësisht dialekti gegë u la në harresë. Në monografinë e tij, “Politika e gjuhës në Shqipërinë socialiste”, të shkruar para 20 vitesh, ai lajmëronte se do të duheshin dhe dy breza nën diktaturë që të shuheshin përfundimisht dy dialektet; duke eliminuar gegërishten dhe toskëzuar gegërishten. Së pari, përmes “spastrimit” të gjuhës së armikut, që ishin katolikë e gegë, si rasti i Fishtës, Camajt, por dhe myslimanë toskë, si Sejfulla Malëshova.

Gjithashtu theksohet se studiuesi Eqrem Çabej punonte nën trysni të madhe dhe kishte frikë të takohej me gjuhëtarë të stigmatizuar nga regjimi.

Kjo çështje e ngritur sërish duket se i ka dhënë shtysën edhe rifunksionimit të Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, të themeluar nga Akademia e Shkencës e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës në vitin 2005. Fillimisht qëllimi i themelimit të këtij Këshilli ishte përmirësimi i të metave aktuale të gjuhës standarde shqipe. Mirëpo, prej katër vjetësh në heshtje, ekzistenca e këtij Këshilli u kujtua vetëm kur filloi të përmendej në kuadrin e debatit të ndezur dhe pas njoftimit se Qendra e Studimeve Albanologjike do të organizojë konferencën shkencore: "Shqipja në etapën e sotme, politikat e pasurimit dhe të përmirësimit të standardit".



Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, i përbërë nga specialistë të gjuhës, që prej krijimit, ka funksionuar më pak se një vit. Gjithsej janë mbajtur dy takime në Tiranë dhe dy në Prishtinë në vitin 2006.


Nënkryetari i ASHSH-së, Muzafer Korkuti, është shprehur se kanë filluar kontaktet me studiuesit e Akademisë së Shkencave të Prishtinës. Vetë kryetari i Akademisë, z. Gudar Beqiraj, ka zhvilluar një vizitë dyditore në Prishtinë në institucionin homolog. Sipas Korkutit, në Prishtinë kanë dërguar edhe një platformë, në të cilën janë parashtruar një sërë problemesh për gjuhën standarde shqipe, e cila do të merret në shqyrtim nga studiuesit kosovarë. “Kjo çështje nuk përfundon me kaq. Pasi të shqyrtohet kjo platformë, do të ketë disa takime mes specialistëve të dy Akademive për t’i shtruar në një tryezë të përbashkët problemet”, - theksoi Korkuti. Ai u shpreh se kjo nënkupton rifillimin e punës së Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe.

Nisur nga mosfunksionimi për katër vjet me radhë, duke folur për domosdoshmërinë e pasurimit të standardit, studiuesi Kolec Topalli ishte shprehur në favor të krijimit të organizmave të reja nëse ky këshill nuk funksionon. “Ka shumë kohë që Këshilli Ndërakademik nuk është mbledhur dhe nuk ka funksionuar. Unë uroj që ai të rifillojë punën dhe çdo organizëm që kërkon të punojë për gjuhën shqipe dhe për standardin është i mirëpritur. Sigurisht që këto probleme

Ndërakademik për Gjuhën Shqipe

nuk zgjidhen menjëherë. Ndoshta do të duhet të krijohen edhe organizma që t'i vënë në jetë", - pati thënë në një intervistë studiuesi Kolec Topalli, në përpjekje për të sqaruar domosdoshmërinë e organizimit të një konference shkencore, ku do të trajtoheshin probleme të gjuhës standarde. Në fakt, duket se hapat e parë janë hedhur.

Në një prononcim të para dy javëve, kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Besim Bokshi, pat thënë se ata i kanë kërkuar sqarime zyrtare Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për ngecjen e punës së këtij Këshilli dhe se prisnin një ftesë zyrtare për rifillimin e punës. Ndërsa, për sa u takon çështjeve që do të duhej të diskutoheshin, Bokshi ka thënë se, "janë çështjet e drejtshkrimit në radhë të parë dhe pastaj çështjet e mbrojtjes së fjalës shqipe nga ndikimet e huaja, çështja e huazimeve të shumta nga anglishtja dhe si duhet të pengohen ato, si dhe probleme të tjera të natyrës së mbrojtjes së gjuhës standarde, pastërtisë së saj, etj".



Në konferencën shkencore: "Shqipja në etapën e sotme, politikat e pasurimit dhe të përmirësimit të standardit" do të diskutohen pak a shumë të njëjtat probleme, por me praninë vetëm të disa studiuesve kosovarë.

Akademiku shqiptar Bahri Beci do të flasë për standardizimin e shqipes, akademiku kosovar Rexhep Ismajli do të mbajë një kumtesë për politikat gjuhësore, gjuhëtari Seit Mansaku do të paraqitet me kumtesën: "Nga gjuha letrare kombëtare te gjuha standarde", drejtuesi i Katedrës së Albanologjisë në Mynih të Gjermanisë, Bardhyl Demiraj do të referojë temën: "Norma gjuhësore dhe substandardi në tekstet shqipe të shek. XVIII në arealin kulturor të Veriut".

Përveç temave me karakter historik do të ketë edhe nga ato që prekin direkt problemin se ç'do të bëhet me gjuhën standarde dhe, me shumë gjasa, do të ketë edhe debate.

Seanca e dytë do t'i kushtohet problemeve gramatikore të standardit. Akademikë e gjuhëtarë si Ethem Likaj, Wilfried Fiedler, Besim Bokshi, Julie May- Kolgjini do të diskutojnë për më shumë çështje që lidhen me morfologjinë e shqipes, çështje që lidhen me formimin e shumësit, gjinive, paskajores, etj. Gjatë ditës së dytë të konferencës, gjuhëtarët do të diskutojnë për problemet e drejtshkrimit dhe të pasurimit të standardit.

Disa nga kumtesat që do të mbahen dhe që i mëshojnë rishikimit të gjuhës standarde, janë ato të Mehmet Elezit (Bernë, Zvicër): "Standardi i ngrirë përballë gjuhës së lirë", "Për një përmirësim të mëtejshëm të shqipes standarde: mbi ndryshimin e disa rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe", nga Mehmet Çeliku (UT), "Rregullat e drejtshkrimit të shqipes standarde dhe disa trajta të diskutueshme", nga Aljula Jubani, shefe e Departamentit të Gjuhësisë në Fakultetin e Histori- Filologjisë në Tiranë, "Pasurimi dhe përmirësimi i standardit vështruar nga pikëpamja e përpunimit teknologjik të gjuhëve natyrore sot", nga Besim Kabashi (Nurenberg, Gjermani). Seanca e dytë e kësaj dite do të merret me marrëdhëniet e standardit me dialektet dhe normën leksikore. Ardian Vebiu (SHBA), Ardian Klosi e Ledi Shamku-Shkreli do të referojnë për dinamikat e pasurimit të shqipes letrare dhe normat leksikore. Të tjerë studiues do të kumtojnë mbi marrëdhëniet e sotme të dialekteve me gjuhën letrare dhe mundësinë e hapjes së kësaj të fundit për dialektet, problemet që has standardi në terminologji, fjalë dhe ndërtime të huaja të panevojshme në shqipen e sotme, etj.

Në ditën e tretë të konferencës do të diskutohet për standardin dhe normat letrare, ku do të diskutohet për përdorimin e gjuhës në letërsinë artistike, në librat shkollorë, në shtypin e shkruar, etj.

Duke iu kthyer funksionimit të Këshillit Ndërakademik për Gjuhën, Muzafer Korkuti theksoi se janë duke përgatitur një kalendar të detajuar mbi veprimtaritë që do të organizohen gjatë vitit që vjen, më 2011, duke garantuar kështu një funksionim në vazhdimësi të këtij Këshilli. ■





Identiteti njerëzor

Muhamed J. KAJOLLI

Përveç identitetit gjeografik të individit, vend të rëndësishëm, bile kryesor, mund të themi se zë edhe identiteti religjioz ose ai ideologjik. Në të gjitha analizat rezulton se idetë religjioze ose ideologjike dominojnë çdo identitet tjetër. Prej këtu themi se nëse një person është nga Prishtina, identiteti tij fillon me emërimin e tij prishtinas, pastaj shqiptar, pastaj ballkanas, pastaj evropian. Pasi të jetë identifikuar gjeografikisht, i njëjti individ, nëse ky shqiptar është musliman, themi se është me identitet musliman, e nëse është i krishterë themi se është i krishterë, ose komunist etj. Kështu do të duhej të identifikohej një individ ose popull.

Për ta kuptuar esencën e fjalës identitet, shembulli që do të na e shpjegonte më së miri këtë është ish-'bashkëjetesa' e popujve të ish-Jugosllavisë. Ky shtet kishte bashkuar popujt që i përkisnin dy religjioneve të mëdha: Krishterizmit (katolik-ortodoks) dhe Islamit. Përpjekja prej disa decenieve për t'i shndërruar të gjithë popujt në një ideologji komuniste dështoi, prandaj erdhi deri te shkatërrimi. Bile, ngjarjet që u zhvilluan në kohën e shkatërrimit të kësaj federate, janë treguesi më i mirë i ndjenjës së vërtetë të identitetit religjioz të njeriut. Nga viti 1991 e deri në vitin 1999 në këtë hapësirë u zhvilluan luftime midis popujve që 'bashkëjetonin për mrekulli'. Por, kush ishin palët ndërluftuese? Përgjigja e kësaj pyetje tregon edhe më qartë ndjenjën e identitetit të një individi ose populli.

Luftimet u zhvilluan midis:

a. Sllovenëve dhe kroatëve, identiteti fetar i të cilëve ishte i krishterë, por i sektit katolik në njërën anë, kundër serbëve identiteti i të cilëve ishte po ashtu i krishterë por, me përkatësi sektare ortodokse

b. Boshnjakëve dhe shqiptarëve, identiteti i të cilëve ishte musliman në njërën anë, kundër serbëve ortodoksë si dhe,

c. Shqiptarëve (muslimanë) kundër maqedonasve të krishterë ortodoksë.

Ky konflikt na bën të konkludojmë se identiteti religjioz ekziston dhe është më i fuqishëm se të gjithë të tjerët së bashku. Sipas kësaj del se të krishterët ortodoksë brenda kësaj federate nuk luftuan vetëm ndërmjet vete sepse ata kishin lidhur aleanca. Si p.sh. serbët, maqedonasit dhe malaziasit (si ortodoksë) u ndanë si një grupim në vete, ndoqën një politikë dhe koha tregoi se këta nuk luftuan ndërmjet vete. Kështu luftime nuk pati as midis kroatëve katolikë dhe sllovenëve katolikë. Gjithashtu nuk pati luftime as midis muslimanëve boshnjakë dhe atyre shqiptarë.

Nëse këto aleanca i studiojmë më në hollësi, atëherë do të vërejmë edhe më qartë se identiteti fetar luan rol vendimtar, sepse është gjeneratori kryesor i cili i vë në lëvizje popujt. Këtë më së miri na e ilustron përgjigja e pyetjes: nga kush u ndihmuan popujt jugosllavë? Perëndimorët, shumica dërmuese e të cilëve janë katolikë, ndihmuan katolikët brenda Jugosllavisë. Këta u qëndruan besnikë deri në fund dhe i ndihmuan me të gjitha mundësitë që kishin në dispozicion.

Në anën tjetër, rusët ndihmuan ortodoksët, ndërsa muslimanët e Jugosllavisë u ndihmuan nga disa shtete muslimane. Bosnja u ndihmua ushtarakisht nga Irani dhe nga disa grupe të tjera më të vogla, të cilët shkuan vullnetarisht vetëm pse i përkisnin të njëjtit besim.

Shembulli tjetër që tregon identitetin religjioz të njeriut është edhe qëndrimi stoik i budistëve te japonezët dhe kinezët. Pas Luftës së Dytë Botërore, këta u ballafaquan me valën përmbysëse të shkollës perëndimore, si në lëmin politik ashtu edhe atë ekonomik. "Jam munduar të tregoj se budistët japonezë kanë shprehur reagim ndaj ndryshimeve intelektuale të periudhës Meiji dhe ndryshimet e filluara nga ta kanë mbetur të kufizuara me shtypin fetar, politikën sektariane dhe botën akademike". "Autorët perëndimorë, për ta kuptuar realitetin e Kinës, kanë filluar gradualisht që t'i kushtojnë më tepër kujdes traditës konfuçiane dhe elementeve budiste sesa vijës moderniste radikale të Maos; ky është refleksion i një ndryshimi metodologjik. Përpjekja për studimin e rrezikut strategjik të Kinës socialiste të Maos ia lëshoi vendin studimit të komponentëve të qytetërimit kinez dhe ndikimit të tyre mbi socializmin kinez. Kësisoj, Kina filloi që të fokusohet më tepër si qendër e një pellgu të veçantë të qytetërimit, sesa si anëtar natyror i polit socialist të botës dypalëshe" (Davutoglu). ■

KOHA PËR TË VAZHDUAR TUTJE

John L. ESPOSITO & Sheila B. LALWANI

Përvjetori i nëntë i 11 shtatorit 2001 kaloi me ceremoni, komemoracione dhe refleksione se ku kemi arritur ne si shoqëri që nga ajo ditë e tmerrshme. Përfundimi është i qartë: Puna rindërtuese është jo komplete.

Ekzistojnë biseda që ende kemi nevojë t'i bëjmë

Muajt e fundit kanë qenë dëshmitare të debateve shqetësuese për marrëdhëniet mes muslimanëve dhe jo muslimanëve, kryesisht si rezultat i propozimit për ndërtimin e një qendre islame afër Ground Zero. Nikoqirët e radiove dhe ekspertët e mediave e kanë bërë këtë çështje një histori kombëtare, dhe ata vlerësojnë se muslimanët ndiejnë keqardhje në mënyrë të pamjaftueshme dhe jo bindëse për aktet e 19 rrëmbyesve dhe se ata janë të pandjeshëm ndaj familjeve të viktimave. Muslimanët ishin të dyshuar për 11 shtatorin, por debatet e fundit që kanë filluar në qytetin e Nju Jorkut kanë nxjerrë në pah boshllëkun e mirëkuptimit mes muslimanëve dhe jo muslimanëve. Situata ka arritur deri në atë pikë ku Presidentit Obama i është dashur të thotë se SHBA-ja nuk është në luftë me Islamin. Ai u përkujtoi njerëzve se muslimanët janë bashkëpunëtorët, fqinjët dhe shokët tanë.

Këto marrëdhënie pothuajse janë harruar. Studimet tregojnë se amerikanët i shohin muslimanët nën një prizëm negativ. Një sondazh i ri i Universitetit Quinnipiac ka nxjerrë se 38% e votuesve kanë një opinion të favorshëm për Islamin, ndërsa 40% kanë opinion të pafavorshëm. Në të njëjtin studim, 50% e votuesve thonë se Islami është fe e paqes, kurse 27% e tyre thonë se Islami e inkurajon dhunën kundrejt jo muslimanëve. Numrat janë të qëndrueshëm edhe në studimet e tjera. Një sondazh i Gallup-it ka zbuluar se 57% e amerikanëve, kur janë pyetur se çfarë admirojnë tek Islami, kanë thënë "asgjë" ose "nuk e di". Një sondazh i fundit i Washington Post ka nxjerrë një opinion tronditës: 49% e amerikanëve e shohin Islamin si të pafavorshëm.

Dëshira e fortë për të parë Islamin përmes prizmit të ekstremizmit mbetet e fuqishme dhe duhet të luftohet, meqenëse është e rrezikshme të ngatërrohet dhe të përzihet shumica muslimane me ekstremistët, të cilët përbëjnë një pjesëz të 1.5 miliard muslimanëve të botës. Nuk ka nevojë t'i detyrojmë muslimanët në përgjithësi dhe muslimanët amerikanë në veçanti që të ndiejnë ose të marrin fajin kolektiv ose përgjegjësinë. Ministra të ndryshëm e kanë denoncuar Islamin dhe kanë tërhequr vërejtjen se ata janë drejtuar për marrjen e pushtetit në Amerikë nga muslimanët.

Historia tregon se kohët e vështira ekonomike i tendosin marrëdhëniet dhe këto kohë nuk duket se janë një përjashtim, pasi ne jemi dëshmitarë të një vale ksenofobie, duke pasur parasysh imigrantët meksikanë dhe muslimanët, dhe ne i përkrahim ligjet anti-imigracion, edhe pse sondazhet e mëdha të Gallup-it dhe Pew-it tregojnë se shumica e muslimanëve amerikanë janë të integruar në ekonomi, arsim, shoqëri dhe politikë. Ata janë në mes të minoriteteve më të suksesshme dhe më të edukuara në SHBA. Është koha që boshllëqet e mirëkuptimit të muslimanëve dhe Islamit të adresohen në vendin e duhur dhe është koha që t'i lëmë pas mitet dhe stereotipet që kornizojnë pikëpamjen që shumë amerikanë kanë për Islamin dhe muslimanët.

Ashtu siç kemi bërë në të kaluarën dhe ashtu siç vazhdojmë ende që ta luftojmë racizmin dhe antisemitizmin, po ashtu është e rëndësishme që t'i adresojmë sistematikisht rreziqet e islamofobisë. Kjo nënkupton se duhet të bëhet një përpjekje e koordinuar nga drejtuesit politikë, fetarë, edukativë dhe medialë që ta adresojnë këtë çështje nga të dy anët e debatit për Parkun 51 (vendi ku supozohet të ndërtohet Qendra Islame) në mënyrë që të bëhen të gjithë së bashku. Nevoja për ta bërë këtë është urgjente, nëse ne duam ta mbrojmë pluralizmin në Amerikë.

Këto janë pikat e mira fillestare për një bashkëbisedim të argumentuar me mendje të freskët. Ne mund të kemi dallime, por ne ndajmë një njerëzi të përbashkët – pa marrë parasysh se nga çfarë mund të frikësohemi.

John L. Esposito, autor i librit "E Ardhmja e Islamit," është profesor universitar i Religjionit dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin Georgetown dhe drejtor themelues i Qendrës për Mirëkuptim Islamo-Krishter. Sheila B. Lalwani është hulumtuese në Qendër.

Revista 'Paqja' ka leje për t'i botuar shkrimet e prof. Espositos, pasi ka arritur marrëveshje personale me profesorin.

Përktheu: Osman D. GASHI

Vendi ku kërkohet të ndërtohet xhami

Ish - Qendra Tregtare, Nju Jork, kullat e rrënuara

Nobelisti i letërsisë për vitin 2010

KULTURA E LIRISË

Mario Vargas LLOSA

Sulmet më efektive kundër globalizimit, zakonisht, nuk janë të lidhura me ekonominë. Në të vërtetë, këto janë shoqërore, etike dhe mbi të gjitha, kulturore. Këto argumente dolën në Seatlle më 1999 dhe më tej në Davos, Bangkok dhe Pragë. Thuhet se: zhdukja e kufijve kombëtare dhe krijimi i një bote të ndërlidhur prej tregtisë, do të shoqërohet me një goditje vdekjeprurëse për kulturat kombëtare dhe rajonale, për traditat, zakonet, mitet, që përcaktojnë identitetin kulturor të çdo vendi. Duke qenë se një pjesë e madhe e botës nuk është e aftë t'i rezistojë produkteve kulturore nga vendet e zhvilluara – ose nga superfuqia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës – që në mënyrë të paevitueshme tërhiqen pas bashkëpunimeve të mëdha ndërkombëtare, kultura e Amerikës Veriore do t'ia imponojë vetes, duke standardizuar botën dhe duke asgjësuar florën e vet të pasur të kulturave të ndryshme. Në këtë mënyrë, të gjithë njerëzit e tjerë dhe jo vetëm të dobëtit, kanë për ta humbur identitetin e vet, shpirtin e vet dhe do të bëhen jo më shumë se kolonitë e shekullit të 21-të – mumiet ose karikaturat e modeluara sipas normave kulturale të një imperializmi, që veç sundimit mbi planet me kapitalin e tyre, forcën ushtarake dhe dijen shkencore, do të imponojnë tek të tjerët gjuhën e tyre, mënyrën e të menduarit, besimin, kënaqësinë dhe ëndrrat. Kjo utopi gjithë ankth ose negative, e një bote që falë globalizimit po humbet larminë gjuhësore dhe kulturore, është përvetësuar kulturalisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nuk është fusha ekskluzive e politikanëve të majtë nostalgjikë, si Marksi, Mao apo Che Guevara. Ky delir i persekutimit – i mbushur me urrejtje dhe ligësi kundrejt gjigantit: Amerika e Veriut – është gjithashtu e dukshme në vendet e zhvilluara dhe kombet me kulturë të lartë. Rasti më famëkeq është ai i Francës, ku kemi parë fushatat e shpeshta qeveritare në mbrojtje të "identitetit kulturor" francez, që mendohet se kërcënohet nga globalizimi.

Një grup i madh intelektualësh dhe politikanësh është alarmuar nga mundësia e prodhuar prej Montaigne, Descartes, Racine, dhe Baudelaire, që vendi – që për një kohë të gjatë ka qenë arbitër i modës në veshje, mendim, art dhe në të gjitha fushat shpirtërore – mund të pushtohet nga McDonald's, Pizza, Kentucky Pula të pjekura, rok, rap, filma hollivudianë, atlete dhe bluza. Kjo frikë ka rezultuar, p.sh. në largimin masiv të Francës nga industria lokale e filmit dhe tashmë kërkon që teatri të shfaqë një numër të caktuar filmash kombëtarë dhe kufizimin e shfaqjes së filmave nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. (Edhe pse shikuar nga këndvështrimi i një kalimtari në rrugët e Parisit, direktivat nuk u respektuan). Kjo është arsyeja pse Jose Bove, fermeri i kryqëzatës kundër ushqimit të krimbur, është shndërruar në një hero për Francën. Me dënimin e tij prej 3 muajsh në burg, popullariteti i tij u përsos. Unë besoj se argumenti i tij kulturor kundër globalizimit është i papranueshëm dhe ne duhet ta pranojmë që thellë brenda tij shtrihet një e vërtetë e padiskutueshme. Në këtë shekull, bota ku jetojmë, do të jetë më pak piktoreske dhe e mbushur me më pak ngjyra, sesa kjo botë që po lëmë pas. Festivalet, veshjet, zakonet, ceremonitë, ritet dhe besimet që në të kaluarën i dhanë humanizëm varieteteve folklorike dhe etnologjike, po zhduken gjithnjë e më shumë ose po e kufizojnë veten kundrejt sektorëve të pakicës, ndërkohë që shoqëria i ka braktisur ato dhe ka përshtatur të tjera që shkojnë më shumë me realitetin e kohës. Të gjitha vendet e botës po e përjetojnë këtë proces, disa më shpejt se të tjerët, por kjo nuk ndodh për shkak të globalizimit, por për shkak të modernizimit. Ka mundësi që të ketë keqardhje për këtë proces që po ndodh dhe të ndihet nostalgji për eklipsin e jetës së dikurshme, veçanërisht nga pika jonë në avantazh, kur dukemi më të kënaqur, më origjinalë, më me ngjyra. Por, ky proces është i pashmangshëm. Regjimet totalitare në vende, si: Kuba apo Koreja e Veriut, me frikën se ndonjë hapje e tyre mund t'i çojë në shkatërrim, krijojnë një lloj hermetizmi dhe nxjerrin të gjitha llojet e frenimit kundër modernizmit.


Mario Vargas Llosa

Madje, këto vende nuk arrijnë as të përvetësojnë infiltrimin modern të ngadaltë dhe minimin gradual të ashtuquajturit identitet kulturor. Teorikisht, mbase, një vend mund ta ruajë identitetin, por vetëm nëse vendos të jetojë në izolim total, duke prerë të gjitha shkëmbimet me kombet e tjera dhe duke praktikuar vetëmjaftueshmërinë. Një identitet kulturor i ruajtur në këtë formë ka për t'i kthyer mbrapsht standardet prehistorike të të jetuarit. Është plotësisht e vërtetë që modern-

izmi krijon shumë forma të zhdukjes së jetës tradicionale. Por, në të njëjtën kohë, ai hap edhe mundësi të reja dhe strukturon një hap të rëndësishëm për një shoqëri si një tërësi. Ja pse, kur jepet mundësia e zgjedhjes krejt lirshëm, njerëzit nganjëherë janë kundër drejtuesve të tyre ose asaj që pëlqehet nga intelektualët tradicionalistë, që zgjedhin modernen. Deklaratat kundër globalizimit dhe në favor të identitetit kulturor zbulojnë një konceptim të pandryshueshëm kulturor, që nuk ka bazë historike. Cila kulturë ka mbetur identike dhe e pandryshuar me kalimin e kohës? Për t'i gjetur ato, ne duhet të kërkojmë midis shoqërive fetare primitive që jetonin nëpër shpella, adhuronin bubullimat dhe kafshët e egra, për shkak të primitivizmit të tyre. Të gjitha kulturat e tjera, në veçanti ato që kanë të drejtë të quhen moderne dhe të gjalla, janë zhvilluar deri në pikën ku ndodhen, por një reflektim i largët të çon tek 2 ose 3 breza më përpara. Ky zhvillim është lehtësisht i dukshëm në vende, si: Franca, Spanja dhe Anglia, ku ndryshimet gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar kanë qenë të veçanta dhe të thella, saqë Marcel Prusti, Federico García Lorca apo Virxhinia Woolf, zor se mund ta pranonin shoqërinë ku jetonin. Nocioni i "identitetit kulturor" është i rrezikshëm. Nga një pikëvështrimi, ai paraqet një koncept të dyshimtë, artificial, por nga një perspektivë politike kërcënon arritjet më të vlefshme të njerëzimit: lirinë. Nuk e mohoj që njerëzit që flasin të njëjtën gjuhë, kanë lindur dhe kanë jetuar në të njëjtin territor, kanë përballur të njëjtat probleme dhe kanë praktikuar të njëjtën fe, zakone, kanë karakter të njëjtë. Por, emëruesi i përbashkët nuk mund që ta përcaktojë kurrë secilin prej tyre dhe kjo vetëm shfuqizon ose shkarkon një plan sekondar përbuzës, si shuma e atributeve unike që trajton ndryshimet e grupit nga të tjerët. Koncepti i identitetit, kur nuk përdoret si një shkallë individuale, është zvogëlues dhe çnjerëzor, një abstraksion ideologjik i të gjithë asaj që quhet origjinale dhe krijuese te qeniet njerëzore, i asaj që është imponuar nga trashëgimia, gjeografia ose tensioni shoqëror. Identiteti i vërtetë del nga kapaciteti i qenieve njerëzore për t'i rezistuar këtyre ndikimeve dhe për t' kundërshtuar ato me veprime krejt të lira, që i vijnë prej sajesave të veta. Nocioni i "identitetit kolektiv" është një trillim ideologjik



dhe themeli i nacionalizmit. Për shumë etnologjistë dhe antropologë, identiteti kolektiv nuk paraqet të vërtetën as midis komuniteteve më arkaike.

Praktikat e thjeshta dhe zakonet mund të jenë themelore për të mbrojtur një grup, por caku i iniciativës dhe kreativitetit midis anëtarëve për emancipimin e vetvetes nga grupi ku bëjnë pjesë, është shumë i madh dhe i pandryshueshëm; ndryshimet individuale triumfojnë mbi tiparet kolektive kur individët ekzaminohen sipas qëllimeve të tyre dhe jo si elementë të thjeshtë periferik të kolektivitetit. Globalizimi shtrin në mënyrë radikale mbi të gjithë njerëzit e këtij planeti mundësinë e strukturimit të identiteteve individuale kulturore përmes veprimit të vullnetshëm, sipas preferencave të tyre dhe motivimeve të brendshme. Tashmë, qytetarët nuk janë gjithnjë të detyruar, ashtu si në të kaluarën dhe në shumë vende tashmë, për të respektuar një identitet që i ngre kurthe atyre në një kamp përqendrimi, nga ku nuk ka shpëtim – identiteti që i është imponuar atyre përmes gjuhës, kombit dhe zakoneve të vendit ku kanë lindur. Në këtë kuptim, globalizimi duhet të mirëpritet, sepse zgjeron sidomos horizontet e lirisë individuale.


Historitë e një kontinenti

Mbase Amerika Latine është shembulli më i mirë i mjeshtërisë dhe absurditetit të përpjekjes për të krijuar identitete kolektive. Si mund të jetë identiteti kulturor i Amerikës Latine? Çfarë mund të përfshihen në këtë grumbull besimesh, zakonesh, traditash, praktikash dhe mitologjish që e pajisin këtë rajon me një personalitet të pazakontë, unik dhe të patransformueshëm? Historia jonë ka qenë e farkëtuar prej polemikave intelektuale – disa edhe mizore – që kërkonin t'i përgjigjeshin kësaj pyetjeje. Më e njohura ishte ajo që fillonte në fillim të shekullit 20, që vuri përballë hispanistët kundër të varfërve dhe pati jehonë anembanë kontinentit. Një historian i njohur, peruani Luis Varcarcel, ka pohuar se kishat, manastiret dhe monumentet e tjera të arkitekturës koloniale duhet të digjen, meqë paraqesin "Anti – Perunë". Ata ishin në vetvete një shfuqizim i identitetit amerikan të pacenuar me rrënjë vendase. Një nga shkrimtarët më origjinalë të Amerikës Latine, Jose Maria Arguedas, ka rrëfyer nëpër histori epizmin e mbijetesës së kulturës në botën andeane, pavarësisht nga prania shtrembëruese e Perëndimit. Hispanicizmi dhe indigjenizmi prodhuan ese historike të shkëlqyera dhe vepra krijuese të arrira, por, gjykuar nga perspektiva jonë, të dyja doktrinat duken njësoj fanatike, degraduese dhe false. Asnjëra nuk është e aftë ta përshtatë ndryshimin e shtrirë të Amerikës Latine në këmishën e forcës ideologjike dhe të dyja kanë shijen e racizmit. Sidoqoftë, përpjekjet për të farkëtuar dhe izoluar "identitetin kulturor" vazhdojnë edhe sot me një zell politik dhe intelektual, që meriton gjëra më me vlerë. Të kërkuarit e imponimit të identitetit kulturor te njerëzit, është njësoj si t'i mbyllësh ata në burg, duke i mohuar lirinë, gjënë më të çmuar – atë të

të zgjedhurit se çfarë, si dhe kush dëshirojnë të jenë. Amerika Latine nuk ka vetëm një, por disa identitete kulturore; asnjë prej tyre nuk mund të pretendojë më shumë legjitimitet ose dëlirësi sesa të tjerët. Sigurisht, që Amerika Latine personifikon botën pre-hispanike dhe kulturën e saj, e cila në Meksikë, Guatemalë dhe vendet andeane ende edhe sot shfaq më shumë forcë sociale. Por Amerika Latine është gjithashtu edhe një mizëri e pafund e oratorëve spanjollë dhe portugezë me një traditë prej 5 shekujsh, prania dhe veprimet e të cilëve kanë qenë vendimtare në dhënien e këtyre tipareve këtij kontinenti. Përbërësit kulturorë, etnikë dhe socialë që zotëron Amerika Latine na lidhin me pothuaj të gjitha rajonet dhe kulturat e botës. Kemi kaq shumë identitete kulturore, a thua se nuk kemi vetëm një. Ky realitet është thesari ynë më i madh, që është në kundërshtim me nacionalistët.

Besimi na bën të aftë të ndihemi si të gjithë qytetarët në botën e globalizuar. Zërat lokalë, frika e amerikanizimit të planetit është një paranojë më ideologjike sesa realiteti. Nuk ka dyshim që me globalizimin, anglishtja është bërë gjuha e kohës, ashtu si gjuha latine në mesjetë. Ndërsa është gjithnjë në shtim e sipër, kjo shndërrohet në një instrument të nevojshëm për operacione ndërkombëtare dhe komunikim. A do të thotë kjo se anglishtja domosdoshmërisht zhvillohet me çmimin e gjuhëve të tjera të mëdha? Absolutisht jo. Në fakt, e vërteta është e kundërta. Zhdukja e kufijve dhe një botë e ndërvarur ka krijuar stimuj për të mësuar dhe përvetëson kulturat e tjera, jo thjesht si një hobi, por edhe si një nevojë, duke qenë se aftësia për të komunikuar me gjuhë të ndryshme në kultura të ndryshme është bërë themelore për suksesin profesional. Merrni parasysh rastin e spanjishtes. Gjysmëshekulli më parë, folësit e spanjishtes jetonin në një komunitet në dukje shpirtëror; e lëshuan veten në rrugët e kufizuara përtej kufijve tradicionalë e gjuhësorë.

Sot, spanjishtja është dinamike dhe e lulëzuar dhe flitet pothuaj në të 5 kontinentet. Fakti që në Amerikë ka 25-30 milionë folës të spanjishtes shpjegon përse 2 kandidatët e fundit për presidentë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, guvernatori i Teksasit George W. Bush dhe zv/presidenti Al Gore, bënë fushatë jo vetëm në gjuhën angleze, por edhe në spanjisht. Sa miliona të rinj, burra dhe gra rreth botës i janë përgjigjur sfidave të globalizimit duke mësuar japonisht, gjermanisht, mandarine, rusisht, frëngjisht? Për fat të mirë, kjo tendencë ka për t'u rritur edhe në vitet në vijim. Ja pse mbrojtja më e mirë e kulturave tona dhe gjuhëve është t'i reklamojë ato furishëm në mbarë botën e re dhe jo të këmbëngulim në pretendimet naive duke vepruar kundër kërcënimit që vjen nga anglishtja. Ata që propozojnë mjete të tilla flasin shumë për kulturën, por tentojnë të jenë njerëz injorantë që e maskojnë profesionin e tyre



të vërtetë: nacionalizmin. Mësimi më i admirueshëm që na mësojnë kulturat është se ne kemi nevojë të mos mbrohemi nga burokratët, ose të izolohemi me qëllim që të mbijetojmë; e kundërta, përpjekje të tilla kanë për ta fishkur kulturën. Kulturat duhet të jetojnë të lira. Liria i rinovon dhe i ringjall ato, duke lejuar të zhvillohen edhe më tej dhe të përshtaten me jetën e përditshme. Në antikitet, latinët nuk i kanë vrarë grekët; e kundërta, origjinaliteti artistik dhe thellësia intelektuale e kulturës greke depërtoi në civilizimin romak dhe përmes tij, poemat e Homerit dhe filozofirat e Platonit dhe Aristotelit mbërritën në gjithë botën. Globalizimi nuk i shfaros kulturat lokale; gjithçka që është e virtytshme në kulturat lokale gjen truall lulëzimi në të. Kjo gjë po ndodh edhe në Evropë, kudo. Veçanërisht e rëndësishme është në Spanjë, kur kulturat rajonale rishfaqen me vrull të veçantë. Gjatë diktaturës së gjeneralit Francisco Franco, kulturat rajonale ishin të shtypura dhe dënoheshin me një ekzistencë klandestine. Por, me kthimin e demokracisë, larmia e pasur kulturore lejoi zhvillimin në mënyrë krejt të lirë. Kulturat lokale kanë pasur një lulëzim të jashtëzakonshëm, veçanërisht në Katalonia, Galicia dhe vendin Baskë, por edhe në pjesën e mbetur të Spanjës. Padyshim që duhet të mos ngatërrojmë kulturën rajonale, rilindjen e saj, që është pozitive dhe e pasur, me fenomenin e nacionalizmit, që parashtron kërcënime serioze për kulturën e lirisë. Në esenë e vitit 1948 "Shënime për përcaktimin e kulturës", T.S. Eliot ka parashikuar se në të ardhmen njerëzimi do të përjetojë një rilindje të kulturave lokale dhe rajonale. Në këtë kohë, profecia e tij dukej shumë e guximshme. Sidoqoftë, globalizimi ka të ngjarë ta bëjë realitet në shekullin e 21-të dhe ne duhet të lumturohemi për këtë. Një rilindje e kulturave të vogla lokale do t'i risjellë njerëzimit atë shumëllojshmëri të pasur të sjelljes dhe pasqyrimeve që shteti-komb asgjëson me qëllim që të krijojë identitetet e ashtuquajtura kombëtare drejt fundit të shekullit të 18-të dhe veçanërisht në shekullin e 19-të. (Ky fakt është harruar lehtësisht dhe ne përpiqemi ta harrojmë atë, për shkak të ngjyrimeve morale të rënda). Kulturat kombëtare shpesh janë ndeshur me gjak dhe zjarr, duke penguar mësimin ose publikimin e gjuhëve amtare ose praktikimin e besimeve fetare dhe zakoneve që nuk pajtohen me idealet. Në këtë mënyrë, në shumë vende të botës, shteti-komb ndikoi te kultura dominuese.

Në kundërshtim me paralajmërimet e atyre që i frikësohen globalizmit, nuk është e lehtë që kulturat të zhduken tërësisht – edhe në qofshin të vogla – nëse prapa tyre është një traditë e pasur dhe njerëzit i praktikojnë ato, madje edhe në fshehtësi. Edhe sot, falë dobësimit të kombit-shtet, ne po kërkojmë harrimin, pakësimin dhe kulturat lokale të heshtura ringjallen dhe shfaqin shenja dinamike jete në këtë koncert të madh të këtij planeti të globalizuar. ■

Poezi që pasqyrojnë realitetin kohor

(Sevdail Demiri "Duke pritur mëngjesin", "Jehona e Karadakut", 2002 Kumanovë, faqe 90)

Bilall MALIQI

Kryq e tërthor i rashë atdheut, kufinjtë e cunguar m'i gjakosën krahët, por fluturimin nuk ma ndalën që ta shoh atdheun në të katër anët".

Me këto vargje prekëse që të ngjallin emocione, me këto vargje që japin një realitet të hidhur por objektiv, fillon libri poetik "Duke pritur mëngjesin" i poetit dhe publicistit të njohur Sevdail Demiri, vargje mjaft domethënëse të cilat na rikujtojnë se me të vërtetë atdheu mbetet ende i cunguar, pavarësisht luftërave të zhvilluara gati në çdo cep të shkëputur të shqiptarëve. Por tek autori ekziston ende optimizmi se fluturimin për ta parë atdheun nga të katër anët nuk mund t'ia ndalë askush. Pra me këto vargje kuptimplote fillon cikli i parë poetik 'Lirisë'.

Motivi patriotik dhe ngjarjet të cilat janë zhvilluar nëpër kohë në nënqiellin tonë e kanë motivuar në masë të madhe autorin që ta shkoqisë dhe ta trajtojë këtë motiv nëpër poezitë e tij, të cilat për nga karakteri janë poezi gjysmëhermetike të pajisura me tematikë të zgjedhur dhe me figuracion të duhur poetik.

Populli ynë ka kaluar nëpër sfida të ndryshme, por qëndresa dhe durimi ka qenë i pranishëm shekuj me radhë tek ai. Simbol qëndrese kanë qenë kullat në të cilat janë mbrojtur nga agresorët e shumtë, por edhe nga tradhtarët e tjerë. Në poezinë 'Qëndresa', shihet qartë mesazhi poetik i autorit:

"Ruaje tymin e oxhakut
Flake urrejtjen brenda kulle
Atdheut dhe tradhëtisë jepja hakun"

Po ashtu, ciklin në fjalë e vazhdojnë edhe më tej poezi të motivit patriotik, të cilat autori i ka veshur me shprehje dhe me figuracion të begatshëm poetik. Kështu, pra, edhe më tej, autori prezanton para nesh poezitë e tjera, të cilat shpalosin artin poetik të autorit, të derdhur gjithandej nëpër poezitë e këtij libri.



Gjurmues i kujdesshëm

Autori gjurmon vazhdimisht idetë frymëzuese të tij dhe vë në spikamë para lexuesve vlerën e poezive në vijën e hollë të shtjellimit të tyre. Poezitë e këtij libri tërheqës për lexim janë të shkruara në vite dhe kohë të ndryshme, varësisht frymëzimit momental të autorit për t'i hedhur në letër mendimet e tij poetike. Pra, tani, para lexuesve Sevdaili na del si një gjurmues i kujdesshëm i ideve dhe vlerës së shkrimeve, të cilat i ka jetësuar me ide, mesazh të qartë dhe veshjen e tyre me figura letrare.

Cikli poetik që kemi para nesh shoqërohet me poezi, shumica e të cilave janë të karakterit patriotik si: 'Gërmadhat e atdheut', 'Përtej lirisë', 'Kthesa', 'Lirisë', 'Atdhe i vrarë' etj., në të cilat shprehet mjaft mirë revolta dhe protesta e autorit nëpër vargje, sepse tek poeti është krijuar koncepti i dhembjes. Kjo shihet qartë në vargjet e poezisë 'Klithje':

"Botë e shurdhër
Ku je"

Kështu poeti i drejtohet botës, e cila asnjëherë nuk e ka shikuar korrekt, qartë dhe arsyeshëm çështjen tonë kombëtare:

"A i dëgjon klithmat e foshnjave
Që digjen në gjirin tënd"

Autori nuk resht së pyeturi Evropën se: 'A i ndjen rënkimet e atdheut tim, për lulet e dhunuara para syve të botës tënde'

Pra, këtë fat tragjik e kishim ne shqiptarët: gjëmimet e pleqve, klithjet

e fëmijëve dhe dhunimet e qindra vajzave shqiptare, në sy Evropës dhe të botës. Dhe këto pyetje të pareshtura të autorit janë shumë të arsyeshme. Këto poezi, gjithnjë të motivit patriotik, të cilat autori ia ka dedikuar shpirtërisht atdheut, do të mbesin vulë e dokumentuar për kohën e shkuar, e cila ishte përplot padrejtësi për të gjithë etnikumin shqiptar.

Autori paraqet në vargje edhe poezi të tjera, të cilat japin një pasqyrë shumë reale të karvanit të zisë, i cili na ka shoqëruar për një kohë të gjatë, e për fat të keq ky karvan po vazhdon ta vrasë atdheun edhe në tkurrjen e tokave tona dhe mosshtrirjes së sovranitetit të plotë në tokat e atdheut tonë. Pjesë e ciklit të parë janë edhe poezitë: 'Vallja tradhtare', 'Oaza e trazuar', 'Vaj', 'Jeta vazhdon', 'Gjurmë agimesh', etj., etj., të cilat mbajnë vlerën e qëndrueshmërisë artistike.

Gjakim i kohës

Në vazhdim të shtjellimit të poezive, para lexuesve na paraqiten poezitë e ciklit të dytë poetik, të cilat janë përmbledhur nën titullin 'Rrugëtime', të cilave autori iu ka dhënë një tematikë të qëlluar. Brenda tyre fshihet porosia e autorit, në mënyrë alegorike me vargje të parimuara, por me një fuqi shprehëse të derdhur gjithandej vargjeve të poezive të këtij cikli dhe më gjerë. Ndër poezitë që mbajnë vlerën e kënaqshme të këtij cikli janë poezia 'Habi', me vargjet interesante dhe të ndërtuara me mjete poetike si:

"Të çoroditur hapërojmë kohën
Me kokën mbrapa
Shikojmë ardhmërinë
E bota gjithnjë na ngelë jashtë
Me jetën moderne"

Edhe te poezitë e tjera që e kompletojnë këtë cikël si: 'Bardh e zi', 'Koha e frustruar', 'Kujtimet boshe', 'Mozaik dhembjesh', 'Gjakim i kohës sime', 'Besa', 'Shpresë edhe pas vdekjes' etj., shihet seriozititeti krijues i autorit.

Cikli i fundit i këtij libri titullohet 'Pritje', cikël ky që përbëhet prej nëntë poezive, te të cilat vërehet motivi i dashurisë i shoqëruar me vargje gjysmëhermetike dhe diku- diku dhe hermetike, të pajisura edhe me figuracion të begatshëm artistik, të shtrirë nëpër vargjet e poezive të këtij cikli poetik. Poezitë që e shoqërojnë këtë cikël janë: 'Pritje', 'Deri kur kështu', 'Shpresa', 'Akrepat e orës', 'Hidhërimi', 'Njollëverdhë', 'Porta e mbyllur' dhe 'Ty bota ime'.

Libri poetik "Duke pritur mëngjesin" i plotëson të gjitha kriteret e librit të botueshëm dhe shoqërohet me vlera të arrira artistike. Shumica e poezive mbajnë vijën e qëndrueshmërisë poetike, gjithnjë duke gjurmuar edhe më tutje vlera drejt krijimit të individualitetit krijues.■

Libri dhe kultura shqiptare

Rrustem R. BERISHA

Ashtu si shumica e fushave dhe veprimtarive jetësore, edhe kultura, për zhvillimin dhe përparimin e saj, ka një proces varësie ose reciprociteti që e përcakton këtë zhvillim dhe përparim të saj.

Kultura duhet kuptuar si një lloj industrie që është shumë më rëndësi për zhvillimin e një shoqërie, mirëpo pasi kultura pasqyron vlerat shpirtërore dhe civilizuese të një shoqërie, ajo duhet të zhvillohet dhe pasurohet në një vazhdimësi edhe pse mund të përballet me faktorë që e dekurajojnë një zhvillim të tillë. Përpos reciprocitetit të ndërvarësisë dhe domosdoshmërisë së zhvillimit të vlerave shpirtërore, si kusht me rëndësi për përparimin e një shoqërie është edhe zhvillimi i kulturës, që kryesisht mbështetet në reciprocitetin dhe ekzistimin e tregut ose konsumuesit e kësaj kulture.

Për një kulturë të zhvilluar, duhet të ketë edhe një treg të fuqishëm, pasi që edhe në kulturë vlen i njëjti ligj, ngase çdo fushë e artit dhe kulturës mund të jetë produktive dhe voluminoze aq sa ka treg të konsumit të këtyre krijimeve dhe aq sa ka njerëz të përgatitur të këtyre fushave të kulturës që e kanë profesion të jetës dhe punës së përditshme të tyre.

Në kushtet e ekonomisë së tregut, fushat që kanë një kërkesë të madhe për treg dhe konsum, ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në rritjen e prodhimit, pra, kërkesa paraqet edhe mundësitë e rritjes së prodhimtarisë, ashtu si në shumë fusha të tjera të jetës.

Ndërsa kultura, edhe pse është një veprimtari që mund të zhvillohet dhe krijohet nga një shtresë e veçantë e shoqërisë, s'mund të ketë një zhvillim të hovshëm dhe të qëndrueshëm pa një shoqëri që është jo vetëm dashamirëse e krijimeve dhe veprave të kulturës po edhe një shoqëri konsumuese, me çka edhe do të reflektonte për një shkallë të lartë civilizuese.

Mirëpo ne duhet të njohim rëndësinë e pazëvendësueshme të kulturës, si i vetmi ushqim shpirtëror dhe i domosdoshëm për individin e një shoqërie të civilizuar dhe emancipuar. Po ashtu, dihet se përcaktues dhe faktor me rëndësi për këtë është baza ekonomike dhe niveli i standardit jetësor të një shoqërie.

Më ka tërhequr vëmendjen një artikull i botuar në shtypin tonë kohë më parë. Aty lexova se në opinionin e kulturës gjermane botoheshin mbi 80.000 tituj librash brenda një viti.

Nga kureshtja fillova të bëja një ballafaqim të këtij realiteti dhe një llogari të thjeshtë krahasuese me botimet në gjuhën shqipe.

Opinioni kulturor gjerman përfshin edhe një pjesë të Zvicrës (gjermanofolëse), po ashtu përfshin edhe Austrinë. Mirëpo edhe përkundër asaj se gjermanët janë njëri ndër popujt më të mëdhenj të Evropës, krahasimi është një tregues jo i lakmueshëm.

Pasi që ne, si tërësi, përbëjmë rreth 10% të popullsisë gjermanofone, duke mos llogaritur edhe diasporën shqiptare, që për nga numri mund të arrijë në së paku dyfishin e kësaj përqindje, në bazë të kësaj ne shohim edhe diferencat tona të opinionit kulturor.

Mund të thuhet se në opinionin tonë, që përfshin botimet në gjuhën shqipe, botohen rreth 1000 deri në 1500 tituj në vit, dhe në vendet e tjera fqinje, që janë popuj të barabartë për nga numri me ne, botohen së paku 5000 tituj librash në vit, ose mbi 15 tituj në ditë. Këta janë treguesit minimalë të editimeve te popujt fqinj.

Andaj këta janë tregues që duhet të ndikojnë në vlerësimin real të opinionit tonë kulturor dhe nivelit të kulturës në shoqërinë tonë.

Pasi që faktor shumë me rëndësi që ndikon në ngritjen dhe zhvillimin e kulturës mbetet tregu i kësaj kulture, do të thotë konsumi ynë i vlerave të artit dhe vlerave shpirtërore, që në të shumtën e rasteve janë jetike për formimin e një personaliteti, po edhe të një shoqërie, duke tejkaluar shumë herë ato materiale, para nesh mbetet obligimi ynë parësor për të aspiruar një ngritje dhe formim intelektual, po edhe pasurim shpirtëror, shumë të nevojshme për personalitetin e veçanërisht për shoqërinë tonë. ■

HERË ZHEG, HERË ACAR



Agim AVDIU

Kohëve të fundit, Evropa është mbërthyer nga një mot me të reshura të mëdha shiu e bore dhe temperatura të ulëta. Shkencëtarët britanikë kanë vërejtur rënie të temperaturave atmosferike që ka "bllokuar" ngrohjen globale dhe kjo ka qenë edhe si rezultat i dimrit të madh që ndodhi në Evropë.

Ata thonë se ky fenomen ka ndikuar vetëm në rajone të caktuara, çka do të thotë se nuk ka një trend të përmirësimit të ngrohjes globale në tërë botën.

Shumë shkencëtarë të klimës besojnë se një shkallë e caktuar e ngrohjes globale tashmë nuk mund të largohet, për shkak të gazrave të liruar në të kaluarën. Prandaj, për ta evituar ngrohjen, lirimi i gazrave duhet të ndalet menjëherë, si dhe duhet të largohen gazrat që tanimë janë liruar në atmosferë, gjë që nuk shihet në horizont.

Hulumtuesit kanë përdorur të dhënat për ndryshimet klimatike në 351 vitet e fundit duke u kthyer te periudha Maunder Minimum, që njihet si periudha kur dielli kishte pasur aktivitet të ulët solar, e që kishte zgjatur për gjysmë shekulli.

Maunder Minimum kishte ndodhur në gjysmën e dytë të shekullit të XVII-të – një periudhë kjo kur kishte dimra të ashpër, të cilën dikush e kishte quajtur "Etapa e shkurtër e akullit". Pas kësaj ka pasur një rritje graduale në aktivitetit diellor që ka zgjatur rreth 300 vjet.

Mike Lockwood, profesor i hapësirës së ambientit dhe fizikës në Universitetin "Reading" të Britanisë, thek- soi se studimet për aktivitetin e



Diellit, të cilat bazohen në të dhënat për 9000 vjet, tregojnë se ka një “ngritje të ulët të temperaturave brenda një periudhe 300-vjeçare, por një rënie drastike të temperaturave në periudhën 100-vjeçare.

Kjo do të ndikojë në mënyrë dinamike në rrymat e lumenjve, të cilët do të kenë një rritje të valëve të tyre prej 7 deri në 12 km mbi sipërfaqen e Tokës dhe do të ndikojë shumë në ndryshimet e kohës. Do të këtë një ngritje të rrymës së ajrit në gjithsecilën hemisferë të Tokës. “Së pari, kryesisht do të preket Evropa, sepse shtrihet poshtë hemisferës veriore, ku ka rrymime të ajrit”, - shpjegon ai.

“Bllokimi” paraqitet kur format e rrymave të ajrit kanë formën “s” dhe shihet në verilindje të Atlantikut, ku do të shkaktojnë përzierje të erërave.

Por, shton ai, nëse rrymat e ajrit “bllokohen” dhe shkojnë në drejtim të Veriut, vjen i ftohti me erëra të thata që vijnë nga Lindja e Evropës, e që rezulton me rënie drastike të temperaturave.

Zgjatja e “bllokimit” gjatë dimrave të kohëve të fundit është përgjegjës për shkaktimin e acarëve që kanë pushtuar Evropën, sidomos vitin e fundit.

“Arsyet janë të mëdha, sepse rrymat e ajrit vijnë te ne nga oqeani Atlantik dhe ngadalë e godasin tokën e Evropës. Nuk do të ketë kushte ose rrethana diku tjetër në botë që u jep një bllokim kaq të madh”. Rënia e aktivitetit të tanishëm diellor pritet që të vazhdojë edhe në dekadat në vijim, duke shkaktuar seri të shpeshta të “bllokadave” që nuk do të rezultojnë me temperaturë nën zero gradë për çdo dimër.

Çrregullimet klimatike si pasojë e lirimit të gazrave

Ngrohja globale duket se është e paevitueshme, prandaj efekti i gjërave që mund të bëhen, mund të jetë i zbehtë. Bile edhe avokatët më të angazhuar për limitimin e lirimit të gazrave, kanë ardhur deri te përfundimi se kontrolli global i lirimit të gazrave ka të ngjarë që të veprojë tepër ngadalë, prandaj është me vend që të studiohen mundësitë e tjera, ato të “gjeo-inxhinieringut”. A mundemi me të vërtetë ta ftohim planetin? Edhe pse kjo mundësi ende nuk është studiuar sa duhet, të dhënat e para flasin pozitivisht. Toka nxehet nga dy burime: nga rrezet e diellit, që hyjnë në atmosferë, si dhe nga gazrat e serrave, që janë ngujuar në atmosferë. Nëse gazrat e serrave arrijnë nivele të rrezikshme, mund të jetë e mundur që të stabilizohet klima duke pakësuar sasinë e energjisë së diellit që vjen në sipërfaqe të Tokës, ose duke reflektuar një sasi më të madhe të saj në hapësirë. Kjo shkencë është në fillet e saj, por gjithçka shkon në favor të asaj se kjo mund të bëhet shpejtë, me efikasitet dhe me çmim të volitshëm, gjë që nuk mund të thuhet për politikat tjera klimatike. Idetë më të mira gjithmonë bazohen në konceptet e vërejtura në natyrë. Shkencëtarët kishin vërejtur se shpërthimi i vullkanit në Malin Pinatubo të Filipineve, në vitin 1991, e kishte ftohur planetin për dy-tri vjet, për gjysmë shkalle të celsiusit. Ka mënyra të riprodhimit artificial të këtij efekti. Për shembull, grimcat ultra të vogla të sulfurit, të injektuara në shtresat e epërme të atmosferës, mund të mënjanojnë 1 – 2% të rrezeve të diellit, gjë që është tepër pak, por që mjafton që të eliminohet ngrohja që pritej të ndodhte këtë shekull. Kjo nuk do ta ndalte acidifikimin e ngadaltë të oqeaneve, të shkaktuar nga nivelet e ngritura të dioksidit të karbonit, por do të mund ta ftohte planetin, duke siguruar edhe kohën e nevojshme që të fillojnë të japin efekt masat e zvogëlimit të sasisë së gazrave të liruar të serrave. Natyrisht, gjeo-inxhinieringu nuk mund të jetë zëvendësim për zvogëlimin e lirimit të gazrave të serrave, por ai do të mund të na mbronte nga efektet e ngrohjes për shumë dekada, përkundër asaj se mund të dalw se teknikat e gjeo-inxhinieringut të tregohet të jenë tepër të rrezikshme. ■



Në Kosovë, për momentin, janë të infektuar 80 persona me HIV

SHTOHEN RASTET E INFEKTIMIT ME HIV

“Në bazë të trendit të rasteve të shënuara për çdo vit, llogaritet që Kosova, brenda vitit, ka 3 deri në 6 raste. Nuk ka ndonjë rritje alarmante. Megjithëkëtë, kjo nuk do të thotë se Kosova është vend i sigurt, sepse nga HIV-i, faktikisht, nuk është i sigurt asnjë vend në botë, e as Kosova në këtë mes”, - shprehet Faik Hoti, zyrtar për informim në Ministrinë e Shëndetësisë

Fatos SHALA

Dita botërore e luftës kundër virusit vdekjeprurës HIV, që shkakton sëmundjen SIDA, e gjen Kosovën me 80 raste të raportuara, që nga evidencimi i pacientit të parë me këtë virus në vitin 1986. Zyrtarët e institucioneve qeveritare, përgjegjëse për shëndetësinë në Kosovë, si dhe përfaqësuesit e Fondit Global ,vlerësojnë se Kosova mbetet ende vendi me prevalencën më të ulët në rajon e më gjerë, sa u përket rasteve të infektimit me virusin HIV. Faik Hoti, zëdhënës i Ministrisë së Shëndetësisë, thotë se rreth 30 për qind e rasteve të infektuara me HIV, të cilat janë shënuar në Kosovë, kanë përfunduar në mënyrë fatale.

“Nuk ka ndonjë rritje alarmante. Megjithëkëtë, kjo nuk do të thotë se Kosova është vend i sigurt. “Deri më tash, në Kosovë janë raportuar 80 raste me HIV/AIDS, prej të cilave 27 kanë përfunduar me vdekje. Gjatë vitit të kaluar janë raportuar 6 raste të reja me HIV/AIDS, 5 prej të cilave kanë qenë të gjinisë mashkullore dhe një ka qenë femër”, - ka thënë Hoti.

Këtë vit, pesë raste me HIV

Ministria e Shëndetësisë, po ashtu, ka bërë të ditur se gjatë këtij viti janë regjistruar pesë raste me virusin HIV në Kosovë. Kjo e fundit, tash e një vit, ka miratuar planin strategjik për luftimin e HIV/AIDS-it. Sipas Faik Hotit, plani synon t’i shfrytëzojë të gjitha mundësitë ekzistuese për ta mbajtur në nivel të ulët infeksionin me virusin vdekjeprurës.

Edhe Fondi Global, përmes një projekti, mbështet luftën kundër virusit HIV. Edona Deva, menaxhere e projektit, thotë se synohet parandalimi i infektimit të kategorive, sipas saj, më të rrezikuara të popullatës. Në këtë grupim, sipas Devës, përfshihen përdoruesit e drogave injektuese, homoseksualët, punëtoret e seksit komercial, të burgosurit dhe të rinjtë e ekspozuar. “Rritja e prevalencës së Hepatitit B dhe C dëshmon se ekziston rreziku edhe për infeksion me HIV”. Personat e testuar në këto grupacione, e kanë tejkaluar numrin 2,500 dhe deri më tani nuk janë gjetur raste të HIV-it në mesin e tyre, përderisa janë zbuluar raste të Hepatitit B dhe C në mesin e përdoruesve të drogave. Është evidente që rritja e prevalencës së Hepatitit B dhe C në mesin e këtyre grupeve, dëshmon se ekziston rreziku edhe për infeksion me HIV”, - thotë Deva. Faik Hoti shpreh bindjen se ky institucion i ka kushtuar vëmendje sigurimit të terapisë për personat që janë prekur nga virusi HIV. “Terapia që ka siguruar ministria për këta pacientë ka qenë ‘combiviri’ dhe ‘efavirenza’. Sigurimi i saj është bërë me ndihmën e Fondit Global, si dhe me ndihmën e Qeverisë së Holandës dhe agjencive të OKB-së, të cilat veprojnë në Kosovë”, - ka thënë Hoti.

Të infektuarit hezitojnë të lajmërohen

“Sa u përket hapave të tjerë, janë hapur edhe disa qendra të testimit vullnetar për HIV/AIDS. Një numër solid i OJQ-ve ka qenë i angazhuar që të ndihmojë në programet parandaluese, në luftën kundër HIV/AIDS-it. Në këtë aspekt, në këtë luftë kanë kontribuar edhe mediat”, - thekson Hoti. Por, sipas Edona Devës, duke pasur parasysh specifikat e infeksionit me HIV, nuk mund të thuhet me siguri nëse ka ndonjë stagnim të përhapjes së infeksionit që shkakton sëmundjen vdekjeprurëse. “Rastet me HIV janë duke u zbuluar. Në sistemin publik kemi raste të reja, të cilat janë zbuluar në Qendrën për këshillimin dhe testimin vullnetar, që ekziston në kuadër të Klinikës Infektive, e që në fakt vijnë nga popullata e përgjithshme”. “Do të thotë, ne jemi fokusuar, me anë të projektit të Fondit Global, në popullatën e cila është më e rrezikuar”, - thekson Deva. Sipas saj, ka edhe raste që e dinë se janë të infektuar me virusin HIV, por që hezitojnë të lajmërohen për trajtim mjekësor. ■

AIDS-i – LUFTA E PASHPRES

Edhe këtë 1 dhjetor, në ditën kundër HIV/AIDS-it, janë evidentuar vetëm 80 raste në Kosovë, edhe pse shumica e profesionistëve mjekësorë nuk e mendojnë këtë si shifër reale të të sëmurëve me HIV, duke u bazuar në vetëdijesimin e ulët të popullatës për t'u testuar për këtë infeksion. Deri më tani, në botë numri i personave që jetojnë me HIV/AIDS është 31.4-35.3 milionë, prej të cilëve 14.8-17.2 milionë janë të gjinisë femërore

Artan N. BEJTA

Republikën e Kosovës e karakterizon fjala "e re". Është i ri si shtet sepse edhe pak mbush tri vjet dhe është shteti që ka më së shumti të rinj. Që nga paraqitja e personit të parë HIV pozitiv në Kosovë në vitin 1986, e deri në fund të vitit 2009, janë regjistruar 79 raste. Me këtë numër të personave të prekur me HIV, Kosova bën pjesë në shtetet me përqindje të ulët. Ndërmjet dukurive të shumta negative, të cilat vërshuan mbi popullin e Kosovës pas përfundimit të luftës, ishte edhe përhapja e këtij virusi vdekjeprurës. Në këtë drejtim, rritja e numrit të të infektuarve solli si rezultat futjen e vendit tonë në mesin e vendeve të ekspozuara karshi kësaj sëmundje, respektivisht në mesin e vendeve me rrezikshmëri të lartë për përhapjen e saj. Ajo çka është më shqetësuese, mbi të gjitha, është fakti se shtresa më e rrezikuar nga ky virus është rinia. Duke marrë parasysh rëndësinë e saj si pjesa më vitale e një vendi dhe si ardhmëria e shoqërisë së një shteti, me të vërtetë, kjo çështje duhet të jetë preokupim i të gjithë instancave relevante dhe i të gjithë atyre që kanë mundësi të japin kontributin e tyre në drejtim të eliminimit të kësaj dukurie negative.



Parandalimi i HIV-it nëpërmjet marrëdhënieve seksuale:

- Abstenimi nga marrëdhëniet seksuale është mënyra më e sigurt e parandalimit të përhapjes së HIV-it ose sëmundjeve të tjera seksualisht të transmetueshme;
- Përdorimi i kondomave latex në çdo marrëdhënie seksuale;
- Parandalimi i HIV-it nëpërmjet mospërdorimit të përbashkët të shiringave dhe kontaktit me gjakun;
- Gjithmonë duhen përdorur pajisje ose mjete të sterilizuara. Asnjëherë nuk duhen përdorur gjilpëra, të cilat i ka përdorur dikush tjetër më herët për të shpuar veshin ose ndonjë pjesë tjetër të trupit, për tatuazh ose për injektim të drogave;
- Testi i HIV-it;
- Testi i HIV-it detekton antitrupat, të cilat janë prodhuar nga qelizat e bardha të gjakut;
- Rezultati pozitiv (HIV+) do të thotë se personi është i infektuar me HIV;
- Secili ka të drejtë që në mënyrë vullnetare, në bazë të anonimitetit dhe të besueshmërisë me pëlqimin e dhënë, të bëjë testin e HIV-it, gjithnjë, duke u këshilluar para dhe pas testimit.

Çka është HIV/AIDS-i?


HIV-i është emër i një virusi, i cili sulmon sistemin imunitar, sistemin natyral të mbrojtjes së organizmit. Pa një sistem të fortë imuniteti, trupi gjen vështirësi në luftimin e sëmundjeve të ndryshme. Ky virus dhe ky infeksion i krijuar quhet ndryshe HIV. Një pjesë shumë e rëndësishme e sistemit imunitar, pa dyshim, janë rruazat e bardha te gjakut. Virusi i HIV-it pushton dhe shkatërron qelizat e caktuara të bardha të gjakut, të quajtura qelizat CD4+. Nëse shumë nga këto qeliza shkatërrohen, trupi nuk mund të mbrojë veten kundër infeksionit. Në përfundim të këtij procesi infektiv, si fazë e fundit e infeksionit HIV, është AIDS-i (Sindromi i Fituar i Mungesës së Imunitetit).

Te personat e sëmurë nga AIDS-i vërehet një numër i ulët i qelizave CD4+ dhe ata marrin infeksione ose kancer me shpejt sesa personat e shëndetshëm dhe ky i fundit është shkaktar për vdekjen e të sëmurit me HIV.

Duhet t'i kemi të qarta dy termet HIV dhe AIDS. Të kesh HIV nuk do të thotë të kesh AIDS. Personit me HIV, edhe pa u trajtuar, i duhet një kohë e gjatë para se të kalojë në AIDS, zakonisht nga 10 deri në 12 vjet. Në këtë mënyrë, nëse HIV diagnostikohet para se të kalojë në AIDS, ilaçet mund ta ulin ose ta ndalojnë dëmtimin e sistemit

	Mesatarisht	Shtrirje
Njerëz që jetojnë me HIV/AIDS në 2009	33.3 milionë	31.4-35.3 milionë
Të rriturit që jetojnë me HIV / AIDS në 2009	30.8 milionë	29.2-32.6 milionë
Gratë që jetojnë me HIV / AIDS në 2009	15.9 milionë	14.8-17.2 milionë
Fëmijët që jetojnë me HIV / AIDS në 2009	2.5 milionë	1.6-3.4 milionë
Njerëz të infektuar rishtazi me HIV në 2009	2.6 milionë	2.3-2.8 milionë
Të rriturit e infektuar rishtazi me HIV në 2009	2.2 milionë	2.0-2.4 milionë
Vdekjeve nga AIDS-i në 2009	1.8 milionë	1.6-2.1 milionë
Jetimët (0-17), për shkak të AIDS-it në 2009	16.6 milionë	14.4-18.8 milionë

SË MES JETËS DHE VDEKJES



imunitar. Me trajtim, shumë njerëz me HIV janë në gjendje të jetojnë një jetë të gjatë dhe aktive.

Si i infekton virusi i HIV-it njerëzit?

Virusi i HIV-it transmetohet kryesisht gjatë aktit të marrëdhënieve seksuale të pambrojtura me një partner të infektuar. Po ashtu, HIV-i mund të transmetohet nëpërmjet kontaktit me gjak të infektuar, si në rast të transfuzionit ose edhe duke dhuruar gjak me anë të shiringave të pasterilizuara.

Këshilla

HIV nuk mund të transmetohet nga kontakti i përditshëm, si ndarja e ushqimit, e përdorimit të të njëjtit peshqir ose fjetja në të njëjtin shtrat, frekuentimi i të njëjtës pishinë, përdorimi i të njëjtit telefon, ose edhe përdorimi i të njëjtës banjë për nevojat personale. Gjithashtu thuhet se HIV-i nuk mund të transmetohet nga pickimi i insekteve të ndryshme.

Infeksioni me HIV në ditët e sotme merret në raste më të shpeshta ndërmjet përdoruesve të drogave të injektuara, si rezultat i përdorimit të shiringave të pasterilizuara.

Nuk janë të rralla as rastet kur HIV-i përçohet nga nëna e infektuar te fëmija i porsalindur. Ky transmetim i virusit mund të ndodhë kurdo, që nga periudha e shtatzënësisë e deri në lindje. Është llogaritur që rreth 1/4 -1/3 e femrave shtatzëna të infektuara dhe të pamjekuara ia kalojnë virusin fëmijëve të lindur prej tyre.

HIV-i gjithashtu mund të transmetohet te të porsalindurit edhe me anën e qumështit të gjirit të nënës së infektuar. Nëse femrat e infektuara marrin një trajtim dhe kurim mjekësor të kontrolluar, ato e ulin ndjeshëm mundësinë e infektimit të fëmijës së tyre me virusin vdekjeprurës.

Cilat gjëra janë të parrezikshme për t'u infektuar me HIV?

Virusi i HIV- it nuk transmetohet nga saliva (pështyma) e një personi të infektuar me HIV nëpërmjet puthjes, megjithëse nuk këshillohet një veprim i tillë me një person të infektuar me HIV. Gjithashtu HIV-i nuk transmetohet nëpërmjet djersës, lotëve, urinës ose edhe feceve.

Po ashtu, është shumë e rëndësishme të dihet se HIV-i nuk mund të transmetohet nga kontakti i përditshëm, si ndarja e ushqimit, e përdorimit të të njëjtit peshqir ose fjetja në të njëjtin

Këshilla

Deri në fund të vitit 2009 në botë ishin 31.4-35.3 milionë njerëz që jetonin të infektuar me HIV, prej tyre, 29.2-32.6 milionë ishin të rritur, 14.8-17.2 milionë ishin të gjinisë femërore, 1.6-3.4 milionë ishin fëmijë, 2.3-2.8 milionë ishin të infektuar të rinj në 2009, numri i të vdekurve nga HIV/AIDS ishte 1.6-2.1 milion, 14.4-18.8 milionë ishin jetimë.

Këshilla

Në Kosovë, testi vullnetar për HIV mund të bëhet në: Klinikën Infektive – QKUK, Prishtinë; Institutin Rajonal të Shëndetësisë Publike, Ferizaj; Laboratorin "Bioticus", Prishtinë; Qendrën Mediko Psikoterapike "Labyrinth", Prishtinë; Institutin Rajonal të Shëndetësisë Publike, Prizren; si dhe në shumë laboratorë privatë në shumë qytete të Kosovës.

shtrat, frekuentimi i të njëjtës pishinë, përdorimi i të njëjtit telefon ose edhe përdorimi i të njëjtës banjë për nevoja personale. Gjithashtu, thuhet se HIV-i nuk mund të transmetohet nga pickimi i insekteve të ndryshme.

Simptomat e personave të infektuar me HIV/AIDS

Fillimi i simptomave te të infektuarit me HIV mund të jenë të ngjashme me gjendjen gripale pas një ose dy muajsh nga dita e infektimit me HIV. Simptoma të tilla janë: temperatura, dhimbja e kokës, lodhja fizike, zmadhimi i nyejve limfatike, zakonisht të dalluara lehtë në qafë dhe në zonat intime.

Simptoma të tilla mund të zhduken te një i infektuar me HIV brenda një jave ose një muaji dhe shumë shpesh mund të ngatërrohen me forma të tjera infeksionesh virale. Gjatë kësaj periudhe, këta persona janë të infektuar dhe HIV-i gjendet në sasi të mëdha në lëngjet gjenitale të tyre. Simptoma më të vazhdueshme dhe më të ashpra mund të mos shfaqen te të rriturit edhe deri pas 10 vitesh nga infektimi me HIV dhe deri pas 2 vitesh te fëmijët. Por kjo periudhë asimptomatike (pa shfaqje simptomash) varion nga individi në individ dhe varet tërësisht nga gjendja shëndetësore e çdo individi. Jo rrallë disa individë mund të shfaqin simptoma pas disa muajsh nga infektimi me HIV, ndërsa disa individë të tjerë mund të mos shfaqin asnjë simptomë për deri në 10 vite. E rëndësishme është të dihet se edhe gjatë periudhës asimptomatike (pa simptoma) virusi vazhdon shumëfishimin e tij aktiv, duke infektuar dhe shkatërruar qelizat e sistemit imun. Në të njëjtën kohë virusi mund të bëhet pjesë përbërëse e disa qelizave dhe të shumëfishohet aty. Virusi HIV i shkatërron në mënyrë të vazhdueshme këto qeliza imune duke e ulur numrin e tyre në shifra drastike deri në eliminimin e tyre të plotë. Mirëpo, përveç zmadhimit të gjëndrave ose nyejve limfatike, ka edhe simptoma të tjera, midis të cilave mund të përmendim: ulje të energjisë, humbje peshe, temperaturë dhe djersitje të shpeshta, infeksione të vazhdueshme orale ose vaginale, skuqje e vazhdueshme e lëkurës, humbje të kujtesës së shkurtër, etj. ■

Këshilla

Testimi duhet bërë 3 muaj pas sjelljes së rrezikshme, por nëse testi del negativ duhet të përsëritet 6 muaj pas sjelljes së rrezikshme, sepse antitrupthave do t'i nevojitet kohë më e gjatë që të krijohen deri në atë nivel sa për t'u detektuar nga testi i gjakut. Testi nuk është parandalim i infektimit me HIV, por është përpjekje për parandalimin e përhapjes së mëtutjeshme nëse personi që testohet del HIV+ . Trajtimi i HIV-it: Për momentin nuk ka mundësi për shërim të HIV/AIDS-it, por ekzistojnë ilaçe, të cilat ia zgjasin jetën personit i cili është i infektuar.

SPREAD THE WORD
NOT THE VIRUS

STOP AIDS
KEEP THE PROMISE



Viti 2011 – fundi i izolimit

Po bëhen gati tri vjet që kur Kosova shpalli pavarësinë, ndërsa sporti kosovar vazhdon të mbetet i izoluar, pasi kërkesat e shumta për anëtarësim në asociacione të ndryshme evropiane janë refuzuar. Udhëheqësit e federatave kosovare ia hedhin fajin për këtë politikës dhe besojnë se viti 2011 do të jetë vendimtar për pranimin e tyre në arenën ndërkombëtare

Alban BILALLI

Kur më 17 shkurt të vitit 2008 Kosova shpalli pavarësinë, u shpresua se me këtë akt u hapën edhe rrugët për sportet që zhvillohen në Kosovë. Por, po bëhen tri vjet dhe sporti mbetet ende i izoluar. Por, përveç izolimit, sportistët u përballën edhe me shumë vështirësi. Kushtet e vështira financiare, mungesa e stadiumeve dhe e palestrave sportive ishin vetëm disa nga vështirësitë. Me gjithë këto vështirësi, garat vazhduan. Për më tepër, krerët e sportit në Kosovë bënë përpjekje maksimale që të anëtarësoheshin në federatat ndërkombëtare të sportit.

Pas shpalljes së Pavarësisë, krerëve të federatave iu shtua apetiti se njohja ndërkombëtare për sportin kosovar nuk do të vononte. Por kanë kaluar tri vjet dhe sportistët nuk mund t'i zhvillojnë aktivitetet sportive në arenën ndërkombëtare. Pengesë për këtë është Komiteti Olimpik i Kosovës, që nuk është pranuar në familjen e madhe të sporteve të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar. Kosova ende nuk është anëtare e OKB-së, gjë që paraqet një problem tjetër. Por kundërshtarët më të mëdhenj janë federatat serbe që po lobojnë kundër pranimit të sportit kosovar në federatat ndërkombëtare. Si pasojë e mospranimit të sportit, shumë të talentuar dhe të talentuara po shuhen. Por edhe ata sportistë, të cilët kanë arritur suksese në klubet e tyre, po e derdhin djersën për kombëtare të huaja e jo për atdheun e tyre, si Luan Krasniqi, i cili bokson nën flamurin dhe himnin e Gjermanisë, Valon Behrami në atë Zvicrës dhe shumë e shumë sportistë të tjerë.

Federatat e vazhduan lobimin

Ndërkombëtarizimi i sportit ishte në agjendën e çdo federate edhe në vitin 2010. Federata e Futbollit të Kosovës bëri ç'ishte e mundur që të pranohej në Federatat Ndërkombëtare të Futbollit FIFA dhe UEFA. Shumë shkresa me vulë të FFK-s dhe të kryetarit të saj janë dërguar në adresë të këtyre dy shtëpive të futbollit. Por përgjigjja e tyre ishte se Kosova duhet së pari të pranohet ndërkombëtarisht si shtet, e më pas futbolli. Edhe pse FFK-ja nuk u pranua në asociacionet ndërkombëtare, gjatë këtij viti, FIFA ka miratuar dy hapa shumë të rëndësishëm për futbollin e Kosovës. Së pari, ajo njeh certifikatat për transferimin e lojtarëve nga klubet nga Kosova, si dhe Kosova nuk figuron më në hartën e Serbisë si territor i saj.

Me të njëjtat probleme si futbolli, ballafaqohet edhe basketbolli. Edhe pse u bënë ndërrime në kryesinë e FIBA-s, zyrtarët e Federatës së Basketbollit të Kosovës shpresuan se me zgjedhjet e reja në FIBA, do të ndërronte edhe qasja e FIBA-s ndaj Kosovës, por kjo nuk ndodhi. Në hendboll, pos klubeve që marrin pjesë në arenën ndërkombëtare, Kosova nuk ka të drejtë të marrë pjesë si shtet në garat që organizon Federata Evropiane e Hendbollit. Klubet nga Kosova, me pjesëmarrjen e tyre në arenën ndërkombëtare, u eliminuan që në ndeshjet e para.

Liga e përbashkët – dalje nga izolimi

Këto ditë është hedhur ideja për formimin e një lige të përbashkët mes Kosovës dhe Shqipërisë. Do të formohet një ligë shqiptare, në të cilën do të ndesheshin ndërmjet vete ekipet nga Shqipëria dhe Kosova.

Kanali televiziv "ABC news" ka hapur një emision të posaçëm në lidhje me një organizim të tillë të futbollit mes dy vendeve, madje në kontinentin evropian kjo nuk do të jetë eksperienca e parë. Klubet e futbollit të Uellsit, në Britaninë e Madhe, luajnë në një ligë të përbashkët me ato të Anglisë, ndërsa Skocia dhe Irlanda e Veriut kanë organizuar kampionatet e tyre. Këto katër vende janë pjesë përbërëse të Britanisë së Madhe. Kështu, do të jetë e mjaftueshme që të arrihet një marrëveshje mes dy federatave të futbollit, që Kosova dhe Shqipëria të formojnë një ligë të tyren të përbashkët, në një të ardhme të afërt.

Pranimi nuk do të thotë fundi i telasheve

Federata Bjeshkatare, e Mundjes, e Pingpongut, të pranuara ndërkombëtarisht, shpresojnë që në vitin 2011 të mos kenë pengesa për pjesëmarrje nëpër kampionate dhe shpresojnë që të mos t'iu mungojnë mjetet financiare nga shteti dhe donatorët privatë. Sigurimi i mjeteve për të dalë jashtë vendit ka qenë preokupim i çdo federate. Ndërkaq, kur mundnin t'i siguronin mjetet materiale, sepse buxheti i tyre është shumë i varfër, u dilte një problem tjetër: sigurimi i vizave, për të cilat iu duhej të pritnin me javë, por, shpeshherë, viza për të udhëtuar u refuzohej. Rasti i fundit ishte në boks, ku boksierëve nga Kosova, për të zhvilluar takimin me Sllovakinë, iu lëshuan vizat vetëm pas nëntë muajsh. Sportistët kosovarë shpresojnë që në vitin 2011 t'u hapen rrugët për pjesëmarrje në garat ndërkombëtare. ■

E tërë Evropa pas Xherdan Shaqirit

Alban Bilalli

Erdhi si 17 vjeçar në klubin e parë të Bazelit, nga akademia e të rinjve të këtij klubi. Me lojërat e bukura të zhvilluara me fanellën e klubit më të madh zviceran, Shaqiri ua mbylli gojën të gjithë atyre analistëve zviceranë të sportit se Shaqiri shumë shpejt do të “fiket” dhe do të kthehet në klubin e të rinjve, ose do të largohet nga Bazeli. Po, nga Bazeli do të largohet, por si kampion. Shaqirin e kërkon e tërë Evropa. E kërkojnë skuadra të nivelit të lartë. E kërkon kampioni i Evropës, Interi. Pastaj Juventusi, Totenhemi, Barcelona, Mançester Junaited, Arsenali, Liverpuli. E kërkon tërë Bundesliga, Bajeni, Hamburgu, Leverkuseni, Dortmundi etj. Emri i tij është i pranishëm çdo ditë në mediat evropiane, e sidomos në ato zvicerane. Pyetja që shtrohet më së shpeshti është se kur do të largohet Shaqiri nga klubi i Bazelit. Gazeta italiane “Tuttosport” shkruante se Juventusi është duke bërë presion për të marrë shërbimet e Shaqirit. Vlera në treg e Shaqirit është afro 11 milionë euro. Në fillim të sezonit llogaritej rreth 7 milionë, por me lojërat e zhvilluara, Shaqiri ka përparuar shumë. Ai është lojtar standard në Përfaqësuesen e Zvicrës. Me Zvicrën ai i ka shënuar njërin ndër golat më të bukur ndaj Anglisë, në muajin shtator për kualifikimet për “Euro 2012”.

Herët për t'u larguar?

Historia ka treguar se shumë futbollist të rinj, të cilët kanë kaluar nga klube të nivelit mesatar në klube të mëdha kanë dështuar. Shumë e shumë talentë, të cilët llogariteshin si yje të së ardhmes sot janë futbollistë të nivelit mesatar. E njëjta gjë mund të ndodhë edhe me Shaqirin, i cili nëse do të largohet drejt një klubi të madh, do ta ketë problem të fitojë një vend titullar. Edhe vetë trajneri i tij te Bazeli, Thorsten Fink është shprehur se Shaqiri duhet ta harrojë largimin, sepse nuk është edha aq i mirë sa mendohet, duhet të rritet ende. "Ashtu si po luan tash duhet të harrojë planet e tij për transferim jashtë. Çdo ditë 'x' persona ia rrahin krahun dhe i thonë se sa i fortë është. Por, për momentin ai nuk është aq i mirë", - ka thënë Fink. Madje gazeta *Blick* ka shkruar se spekulimet për klube të ndryshme të interesuara për Shaqirin, po ndikojnë negativisht me paraqitjet e tij në fushë. Në ndeshjet e fundit janë vërejtur rënie në formën e Shaqirit. Ai ka ndërruar edhe numrin e telefonit për të mos u bezdisur nga telefonatat e shumta në lidhje me transferimin e tij. Xherdan Shaqiri emigroi në Zvicër si fëmijë dhe luajti për SV Augst dhe FC Bazel në ekipin e të rinjve. Shaqiri nënshkroi kontratën profesionale të tij të parë me FC Basel më 2 janar 2009, e cila do të zgjatë deri në janar 2011. Ai debutoi në Basel si zëvendësues në ndeshjen e hapjes së sezonit 2009/2010 kundër FC St Gallen, më 12 korrik 2009. Më 9 nëntor, ai shënoi golin e tij të parë për FC Bazelin, në një fitore 4-1 ndaj Neuchâtel Xamax si vendas. Shaqiri, po ashtu, është lojtar standard edhe në Përfaqësuesen e Zvicrës, me të cilën së fundi ishte edhe pjesëmarrës edhe në kampionatin botëror “Afrika e Jugut 2010”.

Hapësirë për reklamim në revistë!

1/1	1/2	1/4
100€	50€	25€

Në vlerat e çmimeve nuk është përfshirë TVSH-ja

Studio për prodhimin e kuzhinave

KezzA





kkeza@hotmail.com
mob. +377 (0)44 141 909
tel & fax. +381 (0)38 243 863

Prodhimet tona mund të blihen me kredi përmes ***Raiffeisen Bank***

Made in Kosova

JERUSALEMI NË KUR'AN
Libri më i ri që ka botuar Shoqata Kulturore "Zëri Ynë"

